



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 131 Akti

Nr. 83 Vendimi
Tiranë, më 26.11.2018

V E N D I M

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me anë të trupit gjykues të përbërë nga:

Firdes Shuli
Pamela Qirko
Etleđa Çiftja

Kryesuese
Anëtare
Relatore

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Anisa Duka, në prezencë edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Mia Roessingh, e cila zëvendësoi në këtë seancë dëgjimore, z. John LEONARDO, më datë 23 nëntor 2018, ora 12:00, në Pallatin e Koncerteve, kati i I-rë, Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Luan Dervishi, gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Shkodër.**

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**
Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Etleđa Çiftja, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, z. Luan Dervishi, vëzhguesin ndërkombëtar, z. John Leonardo, pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen

që i përket subjektit të rivlerësimit, z. Luan Dervishi, i cili në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin e saj në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT PROCEDURIALE

1. Z. Luan Dervishi, është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Shkodër. Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë të ligjit nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” dhe ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (këtu e më poshtë referuar si “ligji nr. 84/2016”), specifikon se: *“Të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë; të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit ex officio”*.

2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në nenin 179/6, paragrafi 5 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 3, pika 5 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

3. Z. Luan Dervishi i është nënshtuar procesit të rivlerësimit me përparësi duke qenë se fillimisht kishte shprehur interesin për kandidat për anëtar të Gjykatës Kushtetuese, për këtë arsye u shortua, më datë 15 maj 2018, me trupin gjykues nr. 4, të përbërë nga:

Pamela Qirko Komisionere

Firdes Shuli Komisionere

Etleda Çiftja Relatore

4. Më tej, në shtator 2018, subjekti i rivlerësimit ka shprehur interesin për të kandiduar për në Këshillin e Lartë Gjyqësor nga gjykatat e apelit të rretheve, për shkak të vakancës që u krijuar nga shkarkimi i z. Besim Treshnjeva, për këtë arsye është hetuar me përparësi nga ana e Komisionit.

5. Menjëherë me hedhjen e shortit, u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (këtu e më poshtë referuar si “**ILDKPKI**”), sipas neneve 31- 33 të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (këtu e më poshtë referuar si “**DSIK**”), sipas ligjit 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016 dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë (këtu e më poshtë referuar si “**KLD**”), sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.

6. Trupi gjykues nr. 2, i shortuar më datë 15.05.2018, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (këtu e më poshtë referuar si “**Komisioni**”), me vendimin nr. 01, datë 25.05.2018 pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit, të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit; të caktojë kryesuese të trupës, znj. Firdes Shuli; të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

7. Më datë 16.11.2018, trupi gjykues, me anë të vendimit nr. 2 vendosi: (i) të përfundojë hetimin paraprak për subjektin e rivlerësimit, z. Luan Dervishi, bazuar në relatimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitur nga relatori i çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit se i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit, në bazë të Aneksit të Kushtetutës në lidhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, neneve 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji në lidhje me deklarimin e konfliktit të interesit, të

drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si edhe afatin brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta.

8. Më datë 16.11.2018, me anë të postës elektronike, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe që të sjellë prova për të provuar të kundërtën, nëse disponon, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit me *e-mail*; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, neneve 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative, duke paraqitur kërkesë për njohje me dosjen brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit me *e-mail*; (iv) përbërjen e trupit gjykues.

9. Më datë 19.11.2018, subjekti i rivlerësimit kërkoi shtyrjen e afatit të paraqitjes së parashtrimeve përfundimtare. Komisioni i dha dhe një ditë shtesë subjektit të rivlerësimit për të paraqitur shpjegimet e tij në lidhje me rezultatet e hetimit kryesisht.

10. Më datë 22.11.2018, subjekti i rivlerësimit, dërgoi pranë Komisionit shpjegimet e tij së bashku me provat, në protokollin e institucionit dhe me anë postës elektronike.

11. Më datë 16.11.2018, me anë të vendimit nr. 3, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Luan Dervishi, në seancë dëgjimore në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016 dhe, me anë të postës elektronike subjekti i rivlerësimit u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej, më datë 23.11.2018, ora 12:00, në Pallatin e Koncerteve, kati i I-rë, Tiranë.

12. Më datë 23.11.2018, ora 12:00, u zhvillua seanca dëgjimore në prezencë të subjektit të rivlerësimit dhe përfaqësuesit të tij ligjor, av. Ardian Visha me nr. 3525 licence, avokat i Dhomës së Avokatisë Tiranë.

13. Bazuar në pikën 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Luan Dervishi, bazuar në të tri kriteret e rivlerësimit, vlerësimin e pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale

II. SEANCA DËGJIMORE

14. Më datë 23.11.2018 u zhvillua seanca dëgjimore, në prezencë të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Mia Roessingh, e cila zëvendësoi z. John Leonardo.

15. Në seancë subjekti i rivlerësimit u paraqit i shoqëruar nga një përfaqësues ligjor, av. Ardian Visha. Ai parashtrroi shpjegimet e tij në seancë.

16. Seanca dëgjimore e datës 23.11.2018 u ndërpre, për të rifilluar më datë 26.11.2018, për shpalljen e vendimit.

17. Në përfundim të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

18. Subjekti i rivlerësimit, z. Luan Dervishi ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

19. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

20. Sipas kreut IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”:

- i. ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror;
- ii. DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjekti të rivlerësimit duke paraqitur pranë Komisionit një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjekti të rivlerësimit; dhe
- iii. KLD-ja është organi përkatës i vlerësimit profesional i cili në përfundim të shqyrtimit të dokumenteve ligjorë të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit si dhe 5 dokumenteve të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.

21. Megjithëse sa më lart, referuar vendimit nr. 2/2017¹ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

V. RIVLERËSIMI I PASURISË

V/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

22. Me shkresën nr. ***, datë 12.02.2018, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Luan Dervishi, i cili është bërë subjekt deklarues pranë ILDKPKI-së në vitin 2003, me numër indeksi *** dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

23. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratat e interesave private nga viti 2003 deri në vitin 2016 dhe, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar “Deklaratën e Pasurisë së Rivlerësimit Kalimtar, Vetting”, më datë 30.01.2017. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personave të lidhur, është konstatuar:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin dhe ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarinim të rremë;*
- *subjekti gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

V/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

24. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a)

¹ Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezultojnë se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting” të vitit 2017; (b) raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratat e interesave private, periodike vjetore pranë ILDKPKI-së nga viti 2003 deri 2016 (d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (e) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (ç) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, datë 19.11.2018, e në vijim, deri ditën e seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

25. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në (i) verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; (ii) në verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) në evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; dhe (iv) në evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga neni 33, pika 5, e ligjit nr. 84/2016.

26. Mbi dorëzimin e deklaratës së pasurisë sipas ligjit nr. 84/2016. Nga verifikimi i datës së dorëzimit të deklaratës së pasurisë “Vetting” në zbatim të nenit 31/1², rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. Luan Dervishi, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë (duke përfshirë personat e lidhur) në bazë të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, **më datë 24.01.2017**, dhe ky fakt konfirmohet nga ILDKPKI-ja nëpërmjet vërtetimit të lëshuar. Për sa më sipër, subjekti e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30 ditor nga hyrja e tij në fuqi.

V/3. Në lidhje me pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting” të vitit 2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur:

Deklarimet e subjektit të rivlerësimit

1. Truall, me sip. 365 m², në bashkëpronësi me të tjerë me pjesë takuese 48 m², ndodhur, pranë shkollës “*”, Zona Kadastrale ***, regjistruar nr. ***, ***, Tiranë, më datë 25.09.1998.**

Burimi i krijimit:

Dhurim me anë të kontratës, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.09.1998.

a. Komisioni, për vërtetimin e faktit dhe burimit të të ardhurave, administroi nga institucionet:

1.1 Deklaratën “Vetting” për vitin 2017 dhe dokumentacioni bashkëlidhura, dorëzuar pranë ILDKPKI-së, më datë 24.01.2017

1.2 Deklarata e interesave private, për herë të parë, në vitin 2003.

1.3 Kontratë dhurimi, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.9.1998.

1.4 Nga dokumentacioni i administruar nga ZRPP-ja Tiranë³, është kthyer përgjigje se, z. Luan Dervish, ka të regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme, pasurinë me nr. ***,

²Subjekti i rivlerësimit ka detyrimin të plotësojë deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2 të ligjit, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi dhe e dërgon atë pranë ILDKPKI-së.

³Përgjigje nr. ***, datë 18.09.2018, e ZVRPP-së Tiranë, e cila konfirmon se në pronësi të z. Luan Dervishi është regjistruar truall me sip. 365 m², zk ***, vol. ***, fq. *** (Referuar dokumentacionit bashkëlidhur kjo pasuri i përket truallit të fituar me dhurim me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.09.1998, me palë dhuruese Sh. B. dhe M. M dhe palë pranuese e dhurimit Luan Dervishi, A. B, E. Sh, M. M, I. M, H. B, Q. G, ky truall i është dhënë për ndërtim shtetasit M. L)

vol, ***, fq. ***, ZK. ***, lloji i pasurisë truall, me sipërfaqe 365 m², në bashkëpronësi me të tjerë.

1.5 Deklarimet dhënë nga subjekti i rivlerësimit me anë të postës elektronike (*e-mail*) në përgjigje të pyetjeve të Komisionit.

b. Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm.

1.6 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka në pronësi truall për ndërtim të dhuruar me anë të kontratës, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.09.1998, me palë dhuruese, Sh. B dhe M. M dhe palë pranuese e dhurimit, Luan Dervishi, A. B, E. Sh, M. M, I. M, H. B, Q. G për dhurimin e truallit me sip. 328.2 m², në ***, Tiranë.

1.7 Pjesë takuese e deklaruar është: 50 %.

1.8 Nga hetimi kryesisht i Komisionit u konstatua se subjekti i rivlerësimit ka në bashkëpronësi 1/8 pjesë të 365 m² truall, respektivisht 48 m².

1.9 Në lidhje me mënyrën e fitimit të pronësisë, në deklarinim për herë të parë, subjekti i rivlerësimit në vitin 2003 pranë ILDKPKI-së, deklaroi se këtë sipërfaqe truall, sipas pjesës takuese 48 m² e ka blerë në shumën 2.400 USD me burim krijimi të ardhurat nga puna e tij dhe e bashkëshortes ndër vite.

1.10 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti deklaroi se e ka fituar pronësinë me anë të kontratës, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.9.1998, me palë dhuruese, Sh. B, dhe M. M dhe palë pranuese e dhurimit, Luan Dervishi, A. B, E. Sh, M. M, I. M, H. B, Q. G, për dhurimin e truallit me sip. 328.2 m², në ***, Tiranë.

1.11 Në deklarinimet e tij me anë të postës elektronike të datës 20.09.2018, subjekti deklaroi se kjo pronë i është dhuruar, duke shpjeguar se gjatë kohës që ka punuar në Gjykatën e Rrethit Përmet ka pasur marrëdhënie miqësie me z. M. M dhe z. A. B dhe meqenëse ishte larguar njëri nga porositësit, subjekti është ftuar për të marrë pjesë si porositës nga personat e mësipërm. Për këtë qëllim subjekti deklaroi se ka firmosur kontratën e dhurimit pa njohur arsyen e vërtetë, pasi nuk ka qenë pjesë e negociatave.

1.12 **Origjina e truallit**, nis me familjen B., e cila e ka shitur me kontratë, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.08.1998, ndërmjet trashëgimtarëve B. si shitës dhe blerës M. M dhe Sh. B, me objekt truallin me sip. 365 m², në vlerën prej 2.000.000 lekësh.

1.13 **Bazuar në faktet e hetimit administrative, Komisioni i kaloi barrën e provës për sa më poshtë:**

1.14 Ka mospërputhje midis deklarinimit të bërë në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, me deklaratën e deklarinimit për herë të parë në vitin 2003 në lidhje me mënyrën e fitimit të pronësisë së truallit.

1.15 Nuk është paraqitur dokumentacion justifikues ligjor për burimin e krijimit të dhurimit (presupozojmë 2.400 USD), nga personat e tjerë të lidhur, të specifikuar si dhurues me anë të kontratës.

1.16 **Subjekti i rivlerësimit, me anë të shpjegimeve dhe provave dërguar, pranë Komisionit, si dhe deklarinimet në seancën dëgjimore, shpjegoi se konfirmon deklarinimet e mëparshme.**

1.17 Më tej subjekti, paraqiti një provë të re, deklaratë noteriale, datë 20.11.2018, ku shtetasi Shefqet Bakia me cilësinë e dhuruesit, sipas kontratës së dhurimit dhe znj. H. B, me cilësinë hartimit të dy deklaratave të dorës dhe pranueses së dorëzimit të pagesës së çmimit të truallit, konfirmojnë me anë të deklarinimeve të tyre, qëndrimin e mbajtur nga ana ime lidhur me këtë çështje.

1.18 **Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit arrin në përfundimin se:**

1.19 Subjekti i rivlerësimit ka mospërputhje deklarinimesh në lidhje me mënyrën e fitimit të pronësisë së truallit ku ai është bashkëpronar në 1/8 pjesë të sipërfaqes prej 365 m², truall për

ndërtim, referuar deklaratës “Vetting” të vitit 2017 dhe përgjigjeve të pyetësorit nga njëra anë dhe deklaramit në deklaratën e interesave private, për herë të parë, në vitin 2003.

1.20 Subjekti i rivlerësimit e ka fituar pronësinë e këtij trualli me anë të kontratës së dhurimit, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.09.1998, vërtetuar me anë dokumentacionit të ardhur nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë dhe nuk e ka blerë siç dhe ai deklaroi në vitin 2003 pranë ILDKPKI-së.

1.21 Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë se personat e tjerë të lidhur/dhuruesit e këtij trualli kishin të ardhura nga burime të ligjshme për këtë dhurim të bërë, sipas detyrimit të nenit 32, pika 4, e ligjit 84/2016, i cili specifikon se: *“Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive”*

1.22 Në lidhje me provën e re të dërguar nga ana e subjekti të rivlerësimit, deklaratën noteriale, datë 20.11.2018, Komisioni çmon se kjo deklaratë ka vetëm efekt deklarativ për të konfirmuar faktin, por ajo nuk provon të ardhurat e ligjshme të dhuruesit.

1.23 Si konkluzion, subjekti i rivlerësimit, z. Luan Dervishi, ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme nga ana e z. Sh. B për të justifikuar vlerën e truallit të dhuruar atij.

2. Apartament banimi, me sip. 125 m² si dhe një garazh me sip. 40 m², ndodhur në, Rr. “*”, Tiranë, me vlerë ndërtimi 2.500.000 lekë.**

a. Komisioni, për vërtetimin e faktit dhe burimit të të ardhurave, administroi nga institucionet:

2.1 Deklaratën “Vetting” për vitin 2017 dhe dokumentacioni bashkëlidhur, dorëzuar pranë ILDKPKI-së. më datë 24.01.2017

2.2 Deklarata e interesave private periodikë nga viti 2003 deri në vitin 2016.

2.3 Kontratë dhurimi, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.9.1998.⁴

2.4 Dokumentacioni i administruar nga ZRPP-ja Tiranë⁵, ka kthyer përgjigje se, z. Luan Dervishi, ka të regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme, pasurinë me nr. ***, vol ***, fq. ***, ZK ***, lloji i pasurisë truall me sipërfaqe 365 m², në bashkëpronësi me të tjerë.

2.5 Deklarimet dhënë nga subjekti i rivlerësimit me anë të postës elektronike (e-mail) në përgjigje të pyetjeve të Komisionit.

Në lidhje me ndërtimin e këtij apartamenti.

2.6 Kontrata e sipërmarrjes, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.09.1998.

2.7 Vërtetimet e pagave neto nga institucionet deri në vitin 1998 për subjektin e rivlerësimit dhe personin e lidhur/bashkëshorten.⁶

2.8 Dokumentacioni i administruar nga ALUIZNI në lidhje me legalizimin e këtij apartamenti.⁷

Në lidhje me dhënien me qira të apartamentit në vitet 2013 – 2014.

⁴ Kontratë sipërmarrje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.9.1998, me palë porositëse Luan Dervishi, M. M. A. B. E. Sh. M. M. I. M. H. B. Q. G dhe palë sipërmarrëse M. L., ku pala sipërmarrëse merr përsipër ndërtimin e një godine 5 katësh, ku çdo porositës do të ketë një sipërfaqe ndërtimore prej 125 m², kati përdhet do të ketë garazhe për çdo porositës, çmimi i apartamentit 20.000 lekë/m², ku kësti i parë prej 750.000 lekë do të paguhet deri me datë 01.10.1998, kësti i dytë prej 750.000 lekë pasi të ketë përfunduar kati përdhet (garazhet) deri në përfundimin e godinës si karabina; kësti i tretë prej 750.000 lekë deri në përfundim të kështj punimeve dhe kësti i katërt prej 250.000 lekë, në momentin e marrjes në dorëzim të objektit;

⁵ Përgjigje nr. *** prot., datë 18.09.2018 e ZVRPP Tiranë, e cila konfirmon se në pronësi të Luan Dervishi është regjistruar truall me sip. 365 m², zk ***, vol. ***, fq. *** (Referuar dokumentacionit bashkëlidhur kjo pasuri i përket truallit të fituar me dhurim me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.09.1998 me palë dhuruese Sh. B, dhe M. M dhe palë pranuese e dhurimit Luan Dervishi, A. B. E. Sh. M. M. I. M. H. B. Q. G, ky truall i është dhënë për ndërtim shtetasit M. L)

⁶ Librezë pune dhe librezë kontributesh Luan Dervishi; Vërtetim të ardhurash Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, datë 26.10.2016, për Luan Dervishi, periudha 1.11.1993 - 30.6.1994, vlera totale 95.409 lekë; Vërtetim të ardhurash K.L.D nr. *** prot., dt. 27.10.2016, për Luan Dervishi, periudha 1998-2007, vlera totale 8.292.222 lekë; Vërtetim të ardhurash Gjykata e Apelit Shkodër, nr. *** prot., datë 19.1.2017, për Luan Dervishi, periudha 2007 - 2016, vlera totale 14.707.195 lekë; Librezë pune Luljeta Dervishi; Vërtetim të ardhurash Posta Shqiptare Dega Librazhd për Luljeta Dervishi, periudha janar 1994 – tetor 1996, vlera totale 170.018 lekë; Vërtetim të ardhurash D.R.S.SH Elbasan, për Luljeta Dervishi, periudha tetor 1996 – mars 1998, vlera totale 243.406 lekë;

⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 25.10.2018. Vetëdeklarimi për legalizim nr. *** prot., datë 16.03.2005 depozituar në Njësinë nr. *** Tiranë është nënshkruar nga 8 persona M. F. M. L. M. D. P. S. Ç. Q. B. N. A. T. B. H. M. B. E. Dh. Sh. I. R. M. Viti i ndërtimit të pallatit është viti 1998. Funkcioni i objektit pallat banimi dhe garazhe + papafingo (4 kate banimi, 1 kat garazh dhe papafingo). ;Sipërfaqja e zënë është 365 m².; Sipërfaqja e ndërtimit 250 m².; Koeficienti i shfrytëzimit të truallit 68 %; Numri i kateve mbi tokë 6 (5+1) nën tokë.

2.9 Dokumentacioni i administruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në lidhje me pagimin e tatimit mbi qiranë e deklaruar.

Në lidhje me shitjen e apartamentit dhe garazhit në vitin 2011.

2.10 Kontrata e shitjes me rezervë dhe kusht të apartamentit dhe garazhit me çmim shitje në shumën 112.000 euro

2.11 Dokumentacioni i administruar nga ana e “Raiffeisen Bank” për pagesat e kryera deri më tani për apartamentin

b. Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm.

2.12 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka një apartament banimi me sip. 125 m² si dhe një garazh me sip. 40 m², ndodhur në, Rr. “****”, Tiranë, (objekte të pahipotekuara por në proces legalizimi me nr. ***, datë 20.5.2011). Vlera e këtyre objekteve është 2.500.000 lekë.

2.13 Subjekti i rivlerësimit është porositës i këtij apartamenti, sipas kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.09.1998, së bashku me M. M, A. B, E. Sh, M. M, I. M, Luan Dervishi, H. B, Q. N. Sipërmarrës për ndërtimin e apartamentit është z. M. L.

2.14 Kjo kontratë parashikon ndërtimin e një godine 5-katëshe me sip. 250 m², 8 apartamente me 125 m² secili me çmim 20.000 lekë/m², vlera shkon tre këste nga 750.000 lekë (30%) dhe një 250.000 lekë (10%). Në lidhje me këto fakte subjekti i rivlerësimit ka dërguar 8 deklarata me shkrim dore dhe 3 mandatarkëtime të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit.

2.15 Në deklaratën “Vetting” deklarohet ky objekt i ndërtuar sipas kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.9.1998, ndërkohë që sipas kësaj kontrate, nuk përcaktohet koha e fillimit dhe përfundimit të apartamentit të ndërtimit, si dhe të shlyerjes së çmimit të kontraktuar.

2.16 Përfundimi i ndërtimit sipas kontratës së sipërmarrjes është maj 1999, ndërsa në formularin e vetëdeklarimit për legalizim, nr. ***, datë 16.03.2005, përcaktohet viti i ndërtimit 1998. Vetë subjekti deklaroi se ka filluar të banojë në gusht të vitit 1998.

2.17 ALUIZNI, konkretisht Drejtoria e ALUIZNI-t Jug, ka përcjellë praktikën me shkresën nr. *** prot., datë 25.10.2018. Vetëdeklarimi për legalizim nr. *** prot., datë 16.03.2005, depozituar në Njësinë Administrative Nr. ***, Tiranë, është nënshkruar nga 8 persona, M. F. M, Luan M. Dervishi, P. S. Ç, Q. B. N, A. T. B, H. M. B, E. Dh. Sh, I. R. M.

2.18 Në lidhje me sipërfaqen dhe çmimin e kontraktuar dhe të paguar, në kontratën e sipërmarrjes të seksioni të drejtat dhe detyrimet e porositësve, pika 1 specifikohet se “*çdo porositës do të ketë një sipërfaqe ndërtimore prej 125 m² si dhe një garazh në katin përdeh*”. Çmimi për m² të ndërtimit të apartamentit është në vlerën 20.000 lekë.

2.19 ***Në lidhje me burimin e krijimit që ka shërbyer për ndërtimin e këtij apartamenti dhe garazhi,*** në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit deklaroi se si burim krijimi për ndërtimin e këtij apartamenti kanë shërbyer të ardhurat e tij dhe të bashkëshortes nga punësimi ndër vite. Ndërkohë që në deklarin për herë të parë në vitin 2003, subjekti deklaroi si burim krijimi të ardhurat nga avokatia, shitjen e shtëpisë në Librazhd dhe shitjen e zyrës në Librazhd dhe në deklarinimet e bëra në përgjigje të pyetjeve në tetor 2018, subjekti i rivlerësimit deklaroi se si burim krijimi për ndërtimin e shtëpisë 125 m² kanë shërbyer të ardhurat nga puna e tij dhe bashkëshortes ndër vite; të ardhurat nga avokatia; të ardhurat nga shitja e shtëpisë dhe zyrës në Librazhd.

2.20 Pra në lidhje me burimin e krijimit konstatohen mospërputhje të deklarinimeve në kohë të ndryshme si dhe nuk është e qartë se kush është burimi i saktë i krijimit.

2.21 **Për të ardhurat nga puna:** subjekti i rivlerësimit ka të ardhura nga puna për periudhën 1993 - 1998, në shumën 484.369 lekë, ndërsa bashkëshortja ka të ardhura nga puna për

periudhën 1994 - 1998, në shumën 539.621 lekë dhe në total të dy kanë shumën prej 1.024.000 lekësh.

2.22 Subjekti i rivlerësimit ka shpenzuar për mobilimin e apartamentit deri më datë 31.12.1998, shumën prej 120.000 lekësh.

2.23 Në emër të subjektit figuron një depozitë kursimi me afat 12 mujor në shumën 897.807 lekë, në Bankën e Kursimeve, pa përcaktuar vitin se kur, si dhe burimin e kësaj depozite, ndërsa në “Raiffeisen Bank” kontatohet se subjekti ka depozitë në shumë prej 959.081,38, lekësh gjendje më datë 21.12.2004, shumë e cila ka kaluar nga Banka Kursimeve.

2.24 Komisioni, duke marrë në konsideratë burimet e krijimit të ndërtimit të apartamentit në deklaratën “Vetting”, ka kryer një analizë financiare për mjaftueshmerinë e të ardhurave në momentin që është paguar apartamenti, sipas përshkrimit të pagimit të kësteve në kontratën e sipërmarrjes.

2.25 Nga hetimi administrative i Komisionit u konstatua se:

2.26 Ka mospërputhje deklarimesh në lidhje me burimin që ka shërbyer për blerjen e këtij apartamenti, duke krahasuar deklaratën “Vetting” të vitit 2017, deklaratën për herë të parë, në vitin 2003 dhe përgjigjet e pyetësorit në tetor 2018.

2.27 Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat e siguruara nga viti 1989, kur ka filluar punë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Librazhd, për periudhën, 1989 - dhjetor 1992, me cilësinë e kryetarit të gjykatës, e cila kondicionin me fillimin e jetesës bashkëshortore.

2.28 Nuk përcaktohet koha e fillimit dhe përfundimit të apartamentit të ndërtimit, si dhe të shlyerjes së çmimit të kontraktuar. Në deklaratën “Vetting” deklarohet ky objekt i ndërtuar sipas kontratës së sipërmarrjes, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.9.1998, me afat të kryerjes së ndërtimit tetor 1998 - maj 1999, duke e ndarë në katër këste, ndërkohë në përgjigje të pyetësorit të datës 25.09.2018, subjekti i rivlerësimit shprehet se: “...*Punimet e ndërtimit janë përfunduar përgjithësisht në muajt gusht - shtator 1998. Unë kam filluar të jetoj në këtë banesë në muajin gusht 1998. Detyrimet janë shlyer për periudhën, 25.09.1998 - 18.08.1999.*” Data e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes është pas përfundimit të punimeve.

2.29 Nuk u dokumentua deklarimi dhe pagimi i detyrimeve tatimore për të ardhurat e përfituara nga shitja e banesës dhe zyrës në qytetin e Librazhdit, përkatësisht në vitet 1997 dhe 1998 (në vlerën 42.000 lekë). Referuar ligjit nr. 7786, datë 27.01.1994, “Për tatimin mbi të ardhurat personale” të ndryshuar, të ardhurat e realizuara nga shitja e pasurive të paluajtshme taten në masën 3 % të çmimit të shitjes.

2.30 Nuk është dërguar dokumentacion justifikues për të ardhurat nga avokatia

2.31 Subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të shlyer shumën 2.250.000 lekë (minimalisht 3 këstet e çmimit referuar kushteve të kontratës së sipërmarrjes) dhe shumën prej 120.000 lekësh të deklaruar për mobilimin e banesës (pa llogaritur shpenzime për jetesë për periudhën deri më 31.12.1998, si dhe pa përfshirë depozitën e deklaruar në Bankën e Kursimeve, kaluar më pas në “Raiffeisen Bank”).

2.32 Sipas analizës financiare, subjekti i rivlerësimit në vitin 1998 që ka investuar në ndërtimin e këtij apartamenti dhe garazhi, ka një mungesë të ardhurash nga burime të ligjshme, shumën prej 1.346.010 lekësh, sipas tabelës më poshtë:

Analiza financiare për periudhën deri 31.12.1998	Vlera në lekë
Të ardhurat e vërtetuara nga paga e subjekti të rivlerësimit, deri më 31.12.1998	484.369
Të ardhurat e vërtetuara nga paga bashkëshortes së subjektit, deri më 31.12.1998	539.621
Total të ardhura	1.023.990
Shpenzime arredimi të deklaruar	120.000
Total shpenzime	120.000

Pagesa për blerje pasurie	2.500.000
Detyrime shoqërisë ndërtuese	250.000
Pasuri neto	2.250.000
Balanca e fondeve	-1346010

2.33 Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit dhe deklaratet e bëra në seancë dëgjimore arrin në përfundimin se:

2.34 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar burime të ndryshme të krijimit të kësaj pasurie ndër vite dhe ka deklaruar data të ndryshme të përfundimit të punimeve se kur ai ka filluar të banojë, si dhe referuar analizës ekonomike ai nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme në shumën prej 1.346.010 lekësh, për investimin në ndërtimin e këtij apartamenti dhe garazhi, sipas kësteve të paguara, referuar kontratës së sipërmarrjes si dhe shpenzimet për mobilimin e shtëpisë

2.35 Për sa më sipër, Komisioni arsyeton se subjekti i rivlerësimit në lidhje me këtë pasuri ka kryer deklaram të rremë. Duke ju referuar deklaratave të tij në vitin 2003 pranë ILDKPKI-së, deklaratës “Vetting” dhe në përgjigje të pyetësorit, ka mospërputhje të deklaratave, ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e pasurisë dhe mobilimin e saj.

2.36 Subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion justifikues ligjor shumë e të ardhurave të siguruara nga viti 1989, kur ka filluar punë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Librazhd, për periudhën 1989 - dhjetor 1992, me cilësinë e kryetarit të gjykatës.

2.37 Për sa më sipër, Komisioni arsyeton se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të ardhurat gjatë këtyre viteve që kanë shërbyer si burim për ndërtimin e këtij apartamenti dhe garazhi.

2.38 Subjekti i rivlerësimit nuk provoi bindshëm burimin dhe se ka shlyer detyrimet tatimore në lidhje me periudhën kur ai kishte ushtruar aktivitetin si avokat në mars 1995 – mars 1999. Në lidhje me këtë, Komisioni arsyeton se subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave nga avokatia, pasi për këto të ardhura nuk janë paguar detyrimet tatimore sipas ligjit dhe për këtë arsye këto të ardhura nuk merren në konsideratë, bazuar në nenin D, pika 4, të Aneksit të Kushtetutës.

2.39 Në lidhje me pagimin e detyrimeve tatimore për të ardhurat e përfituara nga shitja e banesës dhe zyrës në qytetin e Librazhdit përkatësisht në vitet 1997 dhe 1998 (në vlerën 42.000 lekë). Referuar ligjit nr. 7786, datë 27.01.1994, “Për tatimin mbi të ardhurat personale”, të ndryshuar, të ardhurat e realizuara nga shitja e pasurive të paluajtshme taten në masën 3 % të çmimit të shitjes, subjekti i rivlerësimit nuk duhej ta paguante pasi ligji për këtë taksë ka hyrë në fuqi në vitin 1998.

2.40 Lidhur me pretendimet e subjekti të rivlerësimit, Komisioni arsyeton se:

2.41 Analiza financiare, për burimin e të ardhurave, duhet të llogaritet deri në fund të vitit 1999, kur janë shlyer detyrimet, pagesat, për blerjen e banesës dhe jo deri më datë 31.12.1998, d.m.th të llogaritet paga e subjekti të rivlerësimit, si inspektor pranë KLD-së dhe paga e bashkëshortes për këtë periudhë

Lidhur me këtë pretendim, Komisioni, vlerëson se analiza financiare llogaritet sipas dokumentit ligjor të paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit, kontrata e sipërmarrjes dhe pagesa e kësteve. Si dhe duke marrë në konsideratë shpenzimet e mobilimit në momentin e përdorimit të banesës. Subjekti nuk provoi me dokumentacion ligjor shpjegimet e tij.

2.42 Mosllogaritja e pagës së subjekti të rivlerësimit në punë, për periudhën e qenies gjyqtar deri në vitin 1993, (kryetar gjykate, periudha 1989 - 1992), në Librazhd, të ardhurave nga ushtrimi i profesionit të avokatit për periudhën mars 1995 - mars 1999, si dhe të bashkëshortes së subjektit, për periudhën 1989 - 1992, është e pabazuar, alogjike dhe në kundërshtim me

ligjin, pasi këto të ardhura mund të vërtetohen me anë të librezës së punës që ai ka paraqitur për vete dhe bashkëshorten. Ajo që mungon thotë subjekti është vetëm problemi i përcaktimit të pagës, në këtë periudhe pune, por jo fakti që ka qenë në punë. Në lidhje me këtë mungesë dokumentacioni, subjekti ka paraqitur një vërtetim, ku pasqyrohet fakti se dokumentet nuk ekzistojnë, jo për fajin e subjektit.

Sipas Komisionit, me qëllim që të llogariten nga analiza financiare, subjekti i rivlerësimit duhet të kishte dërguar dokumentacion ligjor provues në lidhje me këto të ardhura, me shumë të përcaktuar, ose t'i provonte Komisionit një shumë të përafërt referente, gjë të cilën ai nuk e bëri. Pra, subjekti arriti të provojë burimin e krijimit, por jo të ardhurat e krijuara.

Neni 32, pika 1, e ligjit nr. 84/2016 parashikon: "Subjekti i rivlerësimit së bashku me deklaratë e pasurisë, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive."

2.43 Ndërkaq, dy "Libreza kontributesh" të paraqitura nga subjekti, nga Dega e Sigurimeve Shoqërore Librazhd, respektivisht, për vitin 1996 - 5.100 lekë, për çdo tremujor, për vitin 1997 - 6.120 lekë për çdo tremujor dhe 7.500 lekë për tremujorin e parë të vitit 1998, të cila së bashku provojë të ardhurat nga aktiviteti si avokat.

Në lidhje me sa më lart, Komisioni, arsyeton se libreza e kontributeve pranë Sigurimeve Shoqërore, nuk është dokumenti i cili provon se subjekti i rivlerësimit ka paguar detyrimet tatimore sipas ligjit. Në këto kushte subjekti i rivlerësimit do t'i kishte vënë në dispozicion Komisionit dokumentin që vërteton se ka paguar tatimet në përputhje me ligjin nr. 7677, datë 03.03.1993, "Për tatimin mbi fitimin", i shfuqizuar me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat, i ndryshuar".

Neni D, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 parashikon se: "Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore."

2.44 Lidhur me fillimin e punimeve të objektit, të mbarimit të tij, të pagimit (shlyerjes) të çmimeve, si dhe të kohës së shfrytëzimit të tij, vetëm me një përjashtim, të një lapsusi, ku ai ka deklaruar se kam filluar të jetoj në vitin 1998. Bëhet fjalë për vitin 1999, pasi, mbas lidhjes së kontratës së sipërmarrjes, shtator 1998, kanë filluar punimet. Veç këtij lapsusi, deklarimet kanë qenë të njëjta dhe konstante - thotë subjekti.

✓ *Komisioni, arsyeton se lapsuset e bëra nga ana e subjekti të rivlerësimit në lidhje me momentin e fillimit të përdorimit të banesës, nuk janë të provuara me dokumentacion ligjor për tu vërtetuar, siç dhe kërkon, neni 32, pika 1, e ligjit nr. 84/2016. Për këtë arsye nuk merret në konsideratë fundi i vitit 1999 por gushti i vitit 1998, kohë e cila vërtetohet me anë të pagimit të kësteve të apartamentit.*

2.45 Lidhur me pagimin e tatimit mbi detyrimet tatimore mbi ardhurat personale të realizuara nga shitja e dy objekteve, të shtëpisë në vitin 1997 dhe të lokalit në vitin 1998, për arsyen e thjeshtë se një detyrim i tillë nuk njihej, nuk ishte i aplikuar dhe nuk ka qenë bërë prezent nga noteri që ka formuluar aktet e shitjes. Ajo që është e rëndësishme - thotë subjekti - është fakti se një detyrim i tillë tatimor, nuk ka qenë ë parashikuar në mënyrë të prerë në ligjin nr. 7786, datë 27.01.1994. Ai është parashikuar në mënyrë të saktë në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat personale", periudhë kur ai i kishte shitur dy sendet e paluajtshme të cituar më lartë.

✓ *Komision e vlerëson pretendimin e subjektit të drejtë dhe të bazuar në ligj.*

Në lidhje me të ardhurat nga qiraja e këtij apartamenti dhe garazhi në vitin 2013, 2014 dhe 2015.

2.46 Në deklaratën "Vetting" të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit, deklaroi të ardhura nga qiraja për vitet 2013, shumën prej 550.000 lekësh ; për vitin 2014, shumën prej 550.000 lekësh dhe ka dorëzuar dy mandate të "Raiffeisen Bank" (derdhje për tatim taksa pa deklaratë

tatimore), përkatësisht, më datë 13.12.2013, në vlerë të paguar 60.000 lekë, me përshkrim “L. Dervishi, Qira, T.Vj, 2013”, si dhe në datë 17.12.2014, në vlerë 60.000 lekë, me përshkrim, “Luan Dervishi, Tat.Qeraja Vj 2014”.

2.47 Në deklarin periodik të vitit 2013, subjekti deklaron të ardhura nga qiradhënia e banesës dhe garazheve në shumën prej 550.000 lekësh, gjithashtu edhe në deklarin periodik të vitit 2014 deklaron të ardhura nga qiradhënia e banesës dhe garazheve në shumën 550.000 lekë.

2.48 Me shkresën kthim përgjigje të noterit L. D, nr. *** prot., datë 18.10.2018., është bashkëlidhur një kontratë qiraje, nr. ***, datë 01.07.2014, me qiradhënës, z. Luan Dervishi dhe qiramarrës, z. P. M, objekti i kësaj kontrate, është dhënia me qira e apartamentit, me sip. 125 m² dhe e vendparkimit përpara pallatit. Kohëzgjatja e kontratës është 1 vit nga data 01.07.2014 - 01.07.2015. Çmimi i qirasë është përcaktuar në vlerën 31.000 lekë në muaj.

2.49 Referuar shkresës, nr. *** prot., datë 26.09.2018, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, citohet se individi, Luan Dervishi, nga të dhënat e kontabilitetit ndër vite nuk ka deklaruar dhe paguar tatimin mbi qiranë.

2.50 Nga hetimi administrative i kryer nga Komisioni u konstatua se, ka mungesë të dokumentacionit justifikues ligjor për dhënien me qira për periudhën 01.01.2013-01.07.2014.

2.51 Ka mospërputhje të vlerës së përfituar të qirasë referuar deklarimeve të viteve 2014 dhe 2015 me kontratën e qirasë të sipërpërmendur.

2.52 Ka mungesë dokumentacioni për pagimin e tatimit të qerasë pasi referuar shkresës nr. *** prot., datë 26.09.2018, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, citohet se individi, Luan Dervishi, nga të dhënat e kontabilitetit ndër vite **nuk ka të deklaruar dhe paguar tatimin mbi qiranë.**

2.53 Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit dhe deklarimet e bëra në seancë dëgjimore arrin në përfundimin se:

2.54 Subjekti i rivlerësimit ka mospërputhje të vlerës së përfituar të qirasë referuar deklarimeve të viteve 2014 dhe 2015 me kontratën e qirasë që ka paraqitur.

2.55 Për sa më sipër, Komisioni, arsyeton se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të rremë.

2.56 Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e shkresës, nr. *** prot, datë 26.09.2018, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, e cila konfirmon se individi, Luan Dervishi, nga të dhënat e kontabilitetit ndër vite nuk ka të deklaruar dhe paguar tatimin mbi qiranë.

2.57 Lidhur nga sa më lart, Komisioni, arsyeton se shuma e përfituar prej 1.100.000 lekësh, nga subjekti nuk konsiderohet e ardhur e ligjshme në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

2.58 *Neni D, pika 4, të Aneksit të Kushtetutës parashikon se: “Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore.”*

2.59 Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur në mënyrë të saktë të ardhurat e përfituar nga qeraja gjatë vitit 2015. Në këto kushte Komisioni arsyeton se subjekti i rivlerësimit ka kryer fshehje të të ardhurave me qëllim që ti shmangej pagimit të detyrimeve tatimore.

2.60 Lidhur me pretendimet e subjekti të rivlerësimit, Komisioni, arrin në konkluzionin se:

2.61 Për periudhat 2013 - 2014, ka bërë dy derdhje, në favorin e tatim taksave Tiranë, nepërmjet dy deklaratave (pa deklarate tatimore). Fakti se këto dy deklarata tatimore janë bërë direkt nga ana e subjektit tregon se ka ekzistuar një praktikë e tillë që, pa qenë subjekt i deklaruar i organit tatimor, mund të paguajë detyrimet tatimore.

Në lidhje me këtë shpjegim, Komisioni, arsyeton se mandatet e “Raiffeisen Bank”(2 copë), me përshkrimin (derdhje për tatim taksa pa deklarate tatimore, nuk konsiderohen provë pasi banka luan vetë rolin e agjentit për të paguar tatimet, por nuk vërteton se ato janë paguar.

Subjekti i rivlerësimit duhet të merrte një vërtetim nga Drejtoria e Përgjithshme dhe/ose Rajonale Tatimore për të vërtetuar që tatimet ishin paguar.

2.62 Për periudhën 2013 dhe gjysmën e vitit 2014, shtëpinë e kanë përdorur për qira disa studente, të cilat në mënyrë të shprehur, nuk firmosën kontratën e qirasë. Aq me tepër që pretendonin faktin se mund të largoheshin në çdo moment edhe për shkak natyrës së studimeve që ndiqnin. Ndodhur në këto kushte, duke mos pasur siguri në një qiradhënie konstante, duke pasur synimin për shitjen e banesës, për të qenë korrekt, duke evituar edhe gabimet e viteve 2003 - 2004 (dhënien e garazheve me qira dhe mospagimin e detyrimeve tatimore) preferova pagimin vjetor për derdhjen e tatim taksave. Në këtë kuptim detyrimet vjetore të paguara, janë më të mëdha nga ato që realisht përlllogariten në zonën ku unë jetoja.

✓ *Sipas Komisionit, shpjegimi i subjektit të rivlerësimit nuk qëndron, pasi arsyet që ai paraqet nuk përbëjnë shkak për të bërë deklaram të rremë.*

2.63 Ndërkaq, lidhur me përmbajtjen e shkresës së Drejtorisë Tatimore Rajonale Tiranë, për mospagimin ndër vite të tatimit mbi qiranë, ajo është alogjike dhe nuk pasqyron të vërtetën. Fakti se subjekti ka jetuar në atë banesë deri në vitin 2011, se ajo është dhënë për herë të parë me qira në vitin 2013 - 2014 dhe se në muajin shkurt 2016 është shitur, subjekti nuk e kupton frazën se nuk është paguar tatimi mbi qiranë ndër vite.

✓ *Komisioni arsyeton se shkresa nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë përbën provë të plotë shkresore, në kuptim të ligjit, për të vërtetuar nëse një subjekt ka paguar apo jo detyrimet tatimore. Fakti që kjo shkresë është lëshuar nga autoriteti përgjegjës siç është Drejtoria Rajonale Tatimore dhe ka konfirmuar se subjekti nuk ka paguar tatimin mbi qiranë, tregon se këto të ardhura nuk janë të ligjshme.*

Neni D, pika 4, e ligjit nr. 84/2016 parashikon se: “Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore.”

Në lidhje me shitjen me kusht dhe rezervë të apartamentit dhe garazhit.

2.64 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit, deklaroi se në bazë të kontratës së shitjes së pasurisë së paluajtshme (me kusht & rezervë), nr. *** rep., nr. *** kol., datë 06.02.2016, objekt banimi, me sip.125 m², i është shitur shoqërisë “****” sh.p.k.

2.65 Kushti i kontratës është legalizimi dhe regjistrimi i apartamentit pranë ZVRPP-së Tiranë, nga i cili varet dhe pagesa e shitjes.

2.66 Sipas kontratës së shitjes me kusht, çmimi i shitjes është në vlerën 112.000 euro ku përfshihen edhe pajisjet elektroshtëpiake dhe orenditë, çmim i cili do të likuidohet me këste, ku vlera 20.000 euro do të paguhej deri, më 25.02.2016, dhe katër këstet e tjera brenda datës 01.06.2018.

2.67 Sipas “Raiffeisen Bank”, rezultoi se në llogarinë nr. *** në euro të subjektit të rivlerësimit, janë kryer transfertat hyrëse, konkretisht: (i) më datë 07.10.2016, transfertë nga “****” sh.p.k., në vlerë 10.000 euro (me përshkrimin likuidim pjesor sipas kontratës datë 06.02.2016 për blerje zyre); (ii) më datë 27.12.2016, kalim nga, z. N. D, në vlerë 4.000 euro (me përshkrimin likuidim i pjesshëm i objektit nga biznesi, NIPT ***; dhe (iii) më datë 27.12.2016, kalim nga z. N. D, në vlerë 6.000 euro (me përshkrimin likuidim i pjesshëm i objektit nga biznesi NIPT ***. Gjendja më datë 30.12.2016, pranë “Raiffeisen Bank” është në shumën 20.000,21 euro.

2.68 Z. Luan Dervishi dhe z. N. D, kanë nënshkruar **deklaratën noteriale, nr. *** rep., nr. *** kol, datë 19.06.2018**, ku përcaktojnë se blerësi N. D nuk ka përmbushur kushtet e kontratës së shitjes ku detyrohej të paguante shumën prej 112.000 eurosh, brenda datës 01.06.2018, në pesë këste. Posedimi i sendit apartament nga blerësi është realizuar më datë 01.02.2016.

2.69 Për periudhën 01.02.2016 - 01.06.2018, blerësi N. D, ka paguar dy këste secili, prej 20.000 eurosh, respektivisht në vitin 2016 dhe tjetri në muajin maj 2018. Z. N. D, deklaroi se çmimi i shitjes nuk është paguar në bazë të kushteve të kontratës së shitjes, për shkak se gjatë periudhës 01.02.2016 - 01.06.2018, nuk ka pasur fuqi paguese. Objekti i shitjes në shumën prej 112.000 eurosh sipas perceptimit të tij nuk ishte vetëm vlera e apartamentit të banimit, por edhe e dy garazheve.

2.70 Subjekti deklaroi se kjo marrëveshje nëpërmjet deklaratës noteriale të vitit 2018, është bërë me qëllim zbatimin e kontratës së shitjes së pasurisë së paluajtshme (me kusht dhe rezervë), nr. *** rep., nr. *** kol., datë 06.02.2016, duke ndryshuar disa nga kushtet e saj si:

- i. Çmimi i shitjes së apartamentit do të jetë 93.800 euro që përfaqëson çmimin prej 670 eurosh për m², për sipërfaqen prej 140 m².
- ii. Afati i likuidimit të kësaj shume është deri në datën 31.12.2018 me kushtin që pala blerëse për periudhën 01.02.2016 dhe më pas deri në momentin e likuidimit të jetë në pozitë të qiramarrësit të sendit, duke paguar një qira në shumën prej 30.000 leksh.
- iii. Blerësi ka të drejtën e cila konkurren ndaj të gjithë personave të tjerë potencialë të blejë edhe garazhet në pronësi të shitësit brenda datës 31.12.2018, me çmimin e ofruar nga shitësi.
- iv. Çmimi i shitjes dhe kushte të tjera të shitjes së garazheve nuk është objekt i kësaj marrëveshjeje.
- v. Me likuidimin e shitjes së apartamentit, pagimin total të çmimit të shitjes dhe të aksesorëve të tjerë, pagimin e qirasë së banesës, sipas kushteve të mësipërme, shitësi Luan Dervishi, do t'i dorëzojë shtetasit N. D, me cilësinë e personit fizik, një deklaratë personale të likuidimit të çmimit të shitjes sipas aktmarrëveshjes.

2.71 Më tej, gjithashtu palët kanë rënë dakord që: *“Nëse njëra nga palët nuk do të realizojë kushtet e kësaj marrëveshjeje brenda datës 31.12.2018, palët në heshtje, pa kryer asnjë veprim tjetër juridik, deklarojnë zgjidhjen e kontratës në këtë mënyrë: Rikthimin e palëve në gjendjen e mëparshme. Detyrimin e palës blerëse N. D, t'i kthejë sendin, apartamentin e banimit, në pronësi të palës shitëse Luan Dervishi, në gjendjen në të cilën ka qenë në datën 01.02.2016, së bashku me vlerën e qirasë mujore, sipas kushteve të përcaktuara më lart. Detyrimin e palës shitëse Luan Dervishi t'i kthejë palës blerëse N. D shumën totale të paguar nga pala blerëse, së bashku me interesat bankare, të rrjedhura nga kjo shumë.”*

2.72 ALUIZNI, konkretisht Drejtoria e ALUIZNI-t Jug, ka përcjellë praktikën me shkresën nr. *** prot., datë 25.10.2018. Vetëdeklarimi për legalizim, nr. *** prot., datë 16.03.2005, depozituar në Njësinë Administrative Nr. ***, Tiranë, është nënshkruar nga 8 persona, M. F. M, Luan M. Dervishi, P. S. Ç, Q. B. N, A. T. B, H. M. B, E. Dh. Sh., I. R. M. Të dhënat e formularit janë: (i) Viti i ndërtimit të pallatit është **viti 1998**. Funkcioni i objektit, pallat banimi dhe garazhe + papafingo (4 kate banimi, 1 kat garazh dhe papafingo); (ii) Sipërfaqja e zënë është 365 m²; (iii) Sipërfaqja e ndërtimit 250 m²; (iv) Koeficienti i shfrytëzimit të truallit 68 %; dhe (v) Numri i kateve mbi tokë 6 (5+1) nën tokë. Shqyrtimi i kësaj praktike ende nuk ka filluar nga kjo drejtori dhe për pasojë nuk ka dokumentacion me të dhëna zyrtare të konstatuara.

2.73 Sipas përgjigjeve të pyetësorit të datës 20.09.2018, subjekti i rivlerësimit deklaroi se deri, më datë 17.08.2018, janë likuiduar pjesa më e madhe e kësteve në vlerën prej 79.400 eurosh nga blerësi N. D, si person fizik, sa deklarohet nga subjekti pas pezullimit të aktivitetit nga shoqëria “****”, më datë 01.11.2016. Kushti është i lidhur me realizimin e legalizimit të objektit pranë ALUIZNI-t dhe regjistrimin pranë ZVRPP-së.

2.74 Blerësi e ka marrë në posedim apartamentin nga data 01.02.2016 dhe do ta mbajë deri në kalimin e titullit të pronësisë.

2.75 Nga hetimi administrativ kryesisht, u konstatua se, ka mospërputhje në lidhje me pagesat e kryera nga blerësi duke krahasuar kontratën e shitjes me transaksionet e kryera nëpërmjet “Raiffeisen Bank”, për shkak se në kontratë blerësi është shoqëria “****”, ndërsa dy prej derdhjeve në bankë si pagesë për apartamentin janë kryer nga shoqëria “****” sh.p.k.

2.76 Pra, kalimi i këtyre shumave nuk është bërë nga shoqëria “****”, e regjistruar me NIPT *** (me të cilën është lidhur kontrata e shitjes së pasurisë së paluajtshme), por ka kalime nga një subjekt tjetër, konkretisht nga shoqëria “****” sh.p.k., regjistruar me NIPT ***, me administrator z. N. D.

2.77 Kontrata e shitjes me kusht nënshkruar në vitin 2016, nuk është respektuar në të shumtën e kushteve të saj.

2.78 Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit dhe deklaratimet e bëra në seancë dëgjimore arrin në përfundimin se:

2.79 Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur në mënyrë të saktë pasurinë në posedim të tij dhe ka kryer deklaratim të rremë për shkak se:

- i. Kontrata e shitjes së pasurisë së paluajtshme (me kusht & rezervë), nr. *** rep., nr. *** kol., datë 06.02.2016, nuk është respektuar nga palët kontraktuese në kushtet thelbësore të saj, si pagimi i kësteve brenda afatit dhe plotësimi i kushtit sipas kontratës.
- ii. Palët kanë vepruar ndryshe nga sa është përcaktuar në kontratë, pa bërë amendimin e kontratës së shitjes me kusht dhe rezervë, siç e pranon dhe vetë subjekti.
- iii. Në qershor 2018, palët ndryshojnë kushtet thelbësore të kontratës si çmimin, afatin i shlyerjes së kësteve si dhe objektin e kontratës.

2.80 Bazuar në sa më sipër, Komisioni, krijon bindjen se shitja e këtij apartamenti nuk ka ndodhur *de facto*, por vetëm *de jure*.

2.81 Subjekti i rivlerësimit nuk mundi të provojë se kushtet e kontratës ishin respektuar, përkundrazi pranoi se ato janë shkelur nga palët si dhe pranoi që kushtet thelbësore të kësaj kontrate janë ndryshuar midis palëve në qershor të vitit 2018.

2.82 Lidhur me pretendimet e subjekti të rivlerësimit, Komisioni arsyeton se:

2.83 Lidhur me pagimin e dy kësteve të kontratës sipas konstatimit, në bisedë me shtetasin N. D, ai i ka deklaruar faktin se ato janë bërë me vullnetin e tij, me cilësinë e përfaqësuesit të shoqërisë “****” sh.p.k.

✓ *Komisioni e gjen shpjegimin e subjekti të rivlerësimit si të drejtë dhe të bazuar në ligj.*

2.84 Lidhur me paqartësinë nëse palët kanë respektuar kontratën e shitjes me kusht dhe rezervë apo jo, subjektit i rezulton se kontrata është në zbatim dhe sipas definimit të saj, ajo pasjellë pasoja juridike, në rast mospërbushje të detyrimeve, mbas datës 01.01.2019.

✓ *Komisioni arsyeton se subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm se përse nuk ishin respektuar kushtet e kontratës.*

3. Në lidhje të ardhurat nga qiraja e garazheve për vitet 2004, 2005 dhe 2006.

a. Komisioni, për vërtetimin e faktit dhe burimit të të ardhurave, administroi:

3.1 Deklaratën “Vetting” të vitit 2017 dhe dokumentacionin bashkëlidhur.

3.2 Deklaratat e interesave privatë, periodikë për vitet 2004, 2005 dhe 2006.

3.3 Shkresës nr. *** prot., datë 26.09.2018, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, ku citohet se individi, Luan Dervishi, nga të dhënat e kontabilitetit ndër vite nuk ka të deklaruar dhe paguar tatimin mbi qiranë

b. Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm.

3.4 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti deklaroi të ardhura nga qiraja e ndërtesës garazhe, për vitin 2004, 2005, në shumën 300.000 lekë.

3.5 Në deklaratat e interesave private, periodike vjetore 2004, 2005 dhe 2006 për të ardhurat e përfituara nga qiraja, subjekti deklaroi qira nga 3 garazhe: (i) në vitin 2004 deklaroi shumën 200.000 lekë të ardhura nga qiraja; (ii) në vitin 2005 deklaroi shumën 100.000 lekë të ardhura

nga qiraja; (iii) në vitin 2006 deklaroi shumën 15.000 deri 20.000 lekë në muaj, të ardhura nga qiraja.

3.6 Referuar shkresës, nr. *** prot., datë 26.09.2018, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, përcaktohet se individ, Luan Dervishi, nga të dhënat e kontabilitetit ndër vite nuk ka të deklaruar dhe paguar tatimin mbi qiranë.

3.7 Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni, kryesisht u konstatua se, subjekti i rivlerësimit nuk ka paguar detyrimet tatimore për të ardhurat e përfituara nga qiraja, për 3 garazhe, respektivisht për vitet 2004, 2005, 2006, pasi referuar shkresës nr. *** prot., datë 26.09.2018, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, citohet se individ, Luan Dervishi nga të dhënat e kontabilitetit ndër vite nuk ka të deklaruar dhe paguar tatimin mbi qiranë.

3.8 Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit dhe deklarimet e bëra në seancë dëgjimore arrin në përfundimin se:

3.9 Subjekti i rivlerësimit nuk ka paguar tatimin mbi qiranë sipas ligjit.

3.10 Lidhur nga sa më lart, Komisioni, arsyeton se shuma e përfutur prej subjekti nga dhënia me qira e 3 garazheve në vitet 2004, 2005 dhe 2006 nuk konsiderohet e ardhur e ligjshme.

Neni D, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 parashikon se: “Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore.”

3.11 Lidhur me pretendimet e subjekti të rivlerësimit, Komisioni arsyeton se:

3.12 Shkresa e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë, datë 26.09.2018, nuk ka lidhje me këtë periudhë, mbasi nuk ka pasur asnjë mundësi të këtij fakti, pasi unë nuk kam qenë asnjëherë subjekt i detyrimeve tatimore.

✓ *Komisioni arsyeton se pretendimi i subjektit nuk qëndron pasi që në momentin që një individ deklaroi të ardhura nga qiraja, ai është subjekt i detyrimit tatimor sipas ligjit “Për tatimin mbi fitimin”.*

4. Në lidhje me garazhin⁸, me sip. 20 m², kaluar në pronësi me anë të deklaratës noteriale, nr. * rep., nr. *** kol., datë 11.03.2000, midis subjektit dhe sipërmarrësit të objektit, z. Mehmet Lamko, dhe numrin e garazheve që posedon subjekti i rivlerësimit.**

a. Komisioni, për vërtetimin e faktit dhe burimit të të ardhurave, administroi:

4.1 Deklaratën “Vetting” të vitit 2017 dhe dokumentacionin bashkëlidhur.

4.2 Deklaratat e interesave privatë, periodikë për vitet 2004, 2005 dhe 2006.

b. Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm.

4.3 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka një garazh me sip. 40 m², që është blerë bashkë me apartamentin me sip. 125 m², dhe një garazh me sip. 20 m² të cilin e ka blerë me anë të deklaratës noteriale, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.03.2000, nga sipërmarrësi i objektit, z. M. L.

4.4 Më tej, subjekti i rivlerësimit deklaroi se pas datës 16.03.1999 i ka paguar sipërmarrësit, z. M. L, shumën prej 950.000 lekësh, e cila përfaqëson vlerën e dy garazheve me nr. 2 dhe të

⁸ Për këtë aset në ILDKPKI subjekti ka paraqitur:

Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.03.2000, ku M. L, në cilësinë e sipërmarrësit për ndërtimin e objektit 5 - katësh në Selitë, Tiranë deklaroi se ka blerë me lekë në dorë garazhin nr. 2 dhe sipërfaqen e lirë të garazhit nr. 0, të cilat ndodhen në ndërtesën objekt i sipërmarrjes, kurse Luan Dervishi, në cilësinë e porositesit deklaroi se pas datës 16.3.1999 i ka paguar sipërmarrësit M. L shumën prej 950.000 lekësh, e cila përfaqëson vlerën e 2 garazheve me nr. 2 dhe të dy sipërfaqeve të tepërta, të dy garazheve me emërtimin 0, të pasqyruara në procesverbalin e datë 16.03.1999, pas kësaj date sipërmarrësi M. L, në këmbin të garazhit nr. 2 dhe sipërfaqes së tepërt të garazhit nr. 0, i ka kthyer vlerën prej 475.000 lekësh.

dy sipërfaqeve të tepërta të dy garazheve me emërtimin 0, të pasqyruara në procesverbalin datë 16.03.1999.

4.5 Pas kësaj datë sipërmarrësi, z. M. L, në këmbim të garazhit nr. 2 dhe sipërfaqes së tepërt të garazhit 0 në krah të majtë, i ka kthyer vlerën prej 475.000 lekësh.

4.6 Po në deklaratën “Vetting”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar (i) *të ardhura nga qiraja e ndërtesës (garazheve), viti 2004/2005 në vlerë përkatësisht 200.000 lekë dhe 100.000 lekë (ii) të ardhura nga qiraja e garazheve në vitin 2013 në vlerë 550.000 lekë (sipas deklaratës tatimore datë 17.12.2014)*

4.7 Në deklaratat periodike të viteve 2004 - 2006, subjekti ka deklaruar të ardhura nga qiraje për 3 garazhet përkatësisht vlerën 200.000 lekë (viti 2004), vlerën 100.000 lekë (viti 2005) dhe vlerën 15.000 - 20.000 lekë/muaj (viti 2006). *Në lidhje me të ardhurat nga qiradhënia për këtë periudhë subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se nuk disponon dokumentacion të pagesës së detyrimeve tatimore.*

4.8 Është pyetur subjekti i rivlerësimit lidhur me mospërputhjen në deklarime në deklaratat periodike vjetore të pasurisë për këto garazhe me pyetësin e datës 20.09.2018. Në përgjigjet e datës 25.09.2018 shprehet se: *“Duke pranuar se është krijuar një konfuzion rreth kësaj pasurie, ose unë nuk kam qenë i qartë në pasqyrimin e saj, po jap këtë sqarim. Është e njëjta pasuri, me të njëjtën sipërfaqe dhe pozicion, pavarësisht emërimit dy ose tre garazhe. Konkretisht, në bazë të kontratës së sipërmarrjes, datë 25 shtator 1998, midis të tjerave, çdo porositi, veç banesës me sip. 125 m², do të kishte në pronësi edhe një garazh. Unë dhe porositi tjetër, z. H. B, kishim të drejtën e preferencës në zgjedhjen e garazhit.*

U ndërtuan 12 garazhe, ku dy prej tyre ishin më të vegjël. Unë kam përzgjedhur një garazh sipas kushteve të kontratës. Më vonë kam blerë edhe dy garazhe të tjera, e dokumentuar me deklaratën noteriale, datë 11.03.2000, nga shtetasi (sipërmarrësi) M. L, përkundrejt shumës 475.000 lekë. Këto garazhe ishin pa mure ndarëse dhe këtu lindë edhe keqkuptimi për shkak se në aspektin formal janë tre por materialisht janë dy.

Këto garazhe (ose sipërfaqe banimi adaptuar më pas) janë përdorur me qira pjesërisht vetëm për periudhën e viteve 2004 dhe 2005. Nuk kam paguar tatimet për faktin se: Sikundër kam sqaruar më lart, godina, për rrjedhojë dhe garazhet nuk kanë qenë komode, të rregulluar mirë dhe për periudha kohe ishin me lagështi.

Në periudhat 2013 - 2014, kur është dhënë banesa me qira (fakt i deklaruar), kanë qenë pjesë e aksesorë të kontratës së qirasë duke u lënë në posedim pa shpërblim të qiramarrësit të banesës si dhe aktualisht që janë lënë në posedim.”

4.9 Nga hetimi administrativ kryesisht u konstatua se, ka mospërputhje në lidhje me numrin dhe sipërfaqen, vlerën dhe mënyrën e përfitimit të garazheve që subjekti posedon midis deklaratës “Vetting” të vitit 2017, deklaratës para fillimit të detyrës dhe deklaratave periodike vjetore në vitet 2004, 2005 dhe 2006.

4.10 Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit dhe deklarimet e bëra në seancë dëgjimore arrin në përfundimin se:

4.11 Subjekti i rivlerësimit ka fshehur numrin dhe sipërfaqen e saktë të garazheve në posedim. Ai nuk arriti të provojë bindshëm të kundërtën e rezultateve të hetimit.

4.12 Nga sa me sipër, Komisioni, arsyeton se subjekti i rivlerësimit ka fshehur dhe paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në posedim, me qëllim që të fshihte burimin e krijimit të tyre.

4.13 Lidhur me shpjegimet e dhëna nga ana e subjektit të rivlerësimit, si më lart, Komisioni, arsyeton se ato janë konfuzë dhe të paqarta dhe nuk shpjegojnë mospërputhjet e konstatuara.

5. Për depozitën pranë “Credins Bank”⁹, krijuar, më datë 08.09.2009, gjendja datë 11.10.2016 (bashkë me interesat), është në vlerën 1.452.532,06 lekë.

⁹ Për këtë depozitë subjekti ka paraqitur në ILDKPKI:

Konfirmim Credins Bank, datë 11.10.2016 dhe nxjerrje llogarie, sipas të cilës Luan Dervishi ka depozitë me gjendje në datë 11.10.2016, në vlerën 1.452.130 lekë.

a. Komisioni, për vërtetimin e faktit dhe burimit të të ardhurave, administroi:

- 5.1 Deklaratën “Vetting” të vitit 2017 dhe dokumentacionin bashkëlidhur.
- 5.2 Deklaratat e interesave private, periodike vjetore të vitit 2009.
- 5.3 Procesverballi i datës 12.05.2009, mbajtur nga përfaqësuesit e ILDKPKI-së.
- 5.4 Dokumentacioni i administruar nga “Credins Bank”.
- 5.5 Deklarimet tuaja dhënë Komisionit me anë të përgjigjeve të pyetjeve me anë të postës elektronike, më datë 20 shtator 2018.

b. Arsytimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm.

5.6 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit, deklaroi se një depozitë pranë “Credins Bank”, krijuar më datë 08.09.2009 dhe gjendja datë 11.10.2016 (bashkë me interesat), është në vlerën 1.452.532,06 lekë.

5.7 Referuar të dhënave nga “Credins Bank”¹⁰, konstatohet se kjo depozitë është në emër të subjektit të rivlerësimit konkretisht: Ilogaria nr. *** në lekë, krijuar në datë 08.09.2009, gjendja në datë 31.12.2016, është në vlerën 1.452.130 lekë.

5.8 Kjo depozitë është krijuar nga transfertat e shumës 1.032.336 lekë, më datë 08.09.2009, nga Ilogaria nr. *** në lekë në emër të subjektit të rivlerësimit e krijuar, më datë 05.03.2009, me një derdhje *cash* në vlerë 1.001.000 lekë.

5.9 Shuma prej 1.032.336 lekësh është vendosur periodikisht në depozitë me afat, për të cilat janë përfituar interesat deri në vitin 2017.

5.10 Nga hetimi administrativ kryesisht u konstatua se, ka mospërputhje në deklaratet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me burimin e të ardhurave për krijimin e depozitës në Credins Bank në vitin 2009 për sa më poshtë:

- i. në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009 shprehet: “*..burim nga kalimi i gjendjes cash të deklaruar për periudhën 2003 - 2009... ”*
- ii. referuar procesverballit, datë 12.05.2009, të mbajtur tek përfaqësuesit e ILDKPKI-së, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*...Duke filluar nga viti 2003 kam deklaruar kursime familjare gjendje cash dhe në vitin 2007 gjendja cash arriti në shumën 2.900.000 lekë...Në vitin 2007 këtë shumë gjendje cash të deklaruar çdo vit e kam kaluar në depozitë në emër të bashkëshortes pranë “Credins Bank”, në vlerë 2.002.000 lekë dhe kam shtuar depozitën bankare në “Raiffeisen Bank” në shumën 814.745 lekë”*
- iii. Referuar përgjigjeve të pyetësorit të datës 20 shtator 2018, shprehet se: “*...Tërheqja e depozitës (vlerës) prej 1.946.600 lekësh, në datën 05.03.2009, përbën edhe veprimin e fundit të mbylljes së kësaj depozite pranë “Raiffeisen Bank”. Një pjesë e shumës prej rreth 1.000.000 lekësh ka shërbyer për hapjen e një depozite të re pranë “Credins Bank” (datë 08.09.2009), ndërkaq pjesa tjetër ka shërbyer për pagesën e djalit në SHBA dhe për nevoja familjare... ”*

5.11 Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit dhe deklaratet e bëra në sëancë dëgjimore arrin në përfundimin se:

5.12 Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegojë bindshëm mospërputhjet që ekzistonin në lidhje me burimin e krijimit të kësaj depozite.

5.13 Për sa më lart, Komisioni, del në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarin të rremë në lidhje me burimin e krijimit të kësaj depozite në deklaratën “Vetting” të vitit 2017.

5.14 Lidhur me shpjegimet e dhëna nga ana e subjektit të rivlerësimit, Komisioni, arsyeton se ato nuk qartësuan mospërputhjet e krijimit të kësaj depozite.

Credins Bank, me shkresën nr. ***prot., datë 06.07.2017, konfirmon depozitën në emër të Luan Dervishi, me gjendje në datë 24.01.2017, në vlerën 1.452.130 lekë.

¹⁰ Shkresa nr. ***prot., datë 17.10.2018

6. Lidhur me automjetin, tip “Ford Focus”.¹¹

a. Komisioni, për vërtetimin e faktit dhe burimit të të ardhurave, administroi:

- 6.1 Deklaratën “Vetting” të vitit 2017 dhe dokumentacionin bashkëlidhur.
- 6.2 Deklaratat e interesave private, periodike vjetore të vitit 2011.
- 6.3 Deklarimet tuaja dhënë Komisionit me anë të përgjigjeve të pyetjeve me anë të postës elektronike më datë 20 shtator 2018 dhe datë 14.11.2018.
- 6.4 Dokumentacioni zyrtar i përcjellë nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor.¹²
- 6.5 Analiza financiare e përgatitur nga ana e Komisionit

b. Arsytimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm.

- 6.6 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka në pronësi një automjet, tip “Ford Focus”, kaluar në pronësi në bazë të kontratës së shitjes, datë 15.02.2011, me shitës “Albanian Motors Company” dhe faturë tatimore, nr. ***, datë 08.06.2011, blerë në shumën 13.900 euro.
- 6.7 Si burim krijimi, subjekti deklaroi të ardhurat nga puna me personin e lidhur/bashkëshorten si dhe kontributin e të ardhurave nga puna e personit të lidhur/djalit.
- 6.8 Nga dokumentacioni zyrtar i përcjellë nga DPSHTRR-ja, rezulton se fatura tatimore e shitjes, nr. 218, datë 08.06.2011, me shitës “Albanian Motors Company” dhe blerës, z. Luan Dervishi dhe znj. L. D, konfirmon vlerën prej 13.900 eurosh.
- 6.9 Në deklarin periodik vjetor të vitit 2011, subjekti ka deklaruar blerje automjeti, tip “Ford Focus”, më datë 10.06.2011, në vlerë 14.000 euro dhe në detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, ka deklaruar kontratë huaje në euro për blerje automjeti në shumën 7.000 euro, si dhe pagesën për shkollën e vajzës (shkolla e mesme në SHBA), në vlerën 5.000 USD (periudha shtator - dhjetor 2011).
- 6.10 Në kontratën e huas, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.03.2011, me huadhënës B. Ç, i cili është njëkohësisht baxhanaku/kunati i bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit dhe huamarrës subjektin, deklarohet huamarrja pa interes e shumës prej 7.000 eurosh, shumë e cila do kthehet nga huamarrësi deri më datë 31.12.2012. Në deklaratat periodike vjetore 2013 dhe 2014, është deklaruar shlyerja.
- 6.11 Me deklaratën (pa noter) të datës 05.05.2015, z. B. Ç, deklaroi se shtetasi Luan Dervishi i ka kthyer, më datë 31.12.2013, shumën 500.000 lekë, dhe më datë 31.12.2014, shumën 500.000 lekë.
- 6.12 Komisioni kreu analizë financiare për të vërtetuar nëse subjekti i rivlerësimit kishte të ardhura nga burime të ligjshme për të blerë automjetin.
- 6.13 Nga hetimi administrativ kryesisht u konstatua se, në lidhje me vërtetësinë e deklarimeve, ka mospërputhje për datat e shlyerjes së pagesave për automjetin: subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka shlyer pagesën në qershor të viti 2011, për të gjithë shumën ndërsa sipas kontratës së shitjes, datë 15.02.2011, parashikohet se në momentin e lidhjes së kontratës bëhej një parapagim prej 2.000 eurosh dhe pjesa tjetër do të bëhej në momentin e marrjes në dorëzim të automjetit.
- 6.14 Ka mospërputhje për mënyrën e shlyerjes, pasi subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit të datës 20.09.2018, ka shpjeguar se automjeti, është blerë më datë 08.06.2011, duke u paguar lekët *cash*. Deri më datë 31.12.2010, subjekti deklaroi se ka poseduar një depozitë bankare në vlerën prej 1.000.000 lekësh, dhe sipas llogaritjeve ka pasur deri në këtë datë vlerën

¹¹ Për këtë aset subjekti ka paraqitur:

Faturë tatimore shitje nr. ***, datë 08.06.2011, me palë shitëse Albania Motor Company dhe pala blerëse Luan dhe L. D, për blerje automjeti “Ford Focus”, vlera 13.900 Euro;

Kontratë shitje datë 15.02.2011, me palë shitëse Albania Motor Company dhe pala blerëse Luan Dervishi, për blerje automjeti Ford Focus, vlera 13.900 Euro;
12 DPSHTRR, me shkresën nr. *** prot, datë 10.07.2017, konfirmon automjetin me targa ***, në b/pronësi të Luan dhe L. D.

prej 1.800.000 lekësh, *cash*, kursime për periudhën 2003 - 2010 (kursimet *cash* janë shtuar me të ardhurat për periudhën janar - maj 2011, në vlerën 500.000 lekë dhe janë pakësuar në janar 2011, në vlerë 500.000 lekë nga hapja e depozitës në “Credins Bank”. Në disponim ka qenë shuma prej 1.800.000 lekësh - thotë subjekti.

6.15 Nuk është paraqitur dokumentacion justifikues ligjor për burimin e krijimit të vlerës prej 7.000 eurosh të dhëna borxh nga z. B. Ç, i cilësuar si huadhënës në deklarin e vitit 2011.

6.16 Nuk është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit huaja e marrë nga z. B. Ç, në deklaratën “Vetting” si burim i krijimit për automjetin, tip “Ford Focus”.

6.17 Në lidhje me burimin e krijimit, u konstatua se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e likuiditeteve dhe blerjen e automjetit në vitin 2011, në vlerën 1.998.185 lekë.

6.18 Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit dhe deklarinimet e bëra në seancë dëgjimore arrin në përfundimin se:

6.19 Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarin të rrem në lidhje me mënyrën e shlyerjes dhe burimin që ka shërbyer për blerjen e këtij automjeti.

6.20 Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar huan e marr nga z. B. Ç, në deklaratën “Vetting” si burim i krijimit për automjetin, tip “Ford Focus”, ndërkohë që në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011, deklaroi se automjetin e ka blerë me një pjesë nga huaja e marrë.

6.21 Për sa më lart, Komisioni, arsyetoi se subjekti ka paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi dhe ka kryer deklarin të rrem.

6.22 Subjekti i rivlerësimit ka mungesë financiare në shumën - 1.998.185 lekë, në vitin 2011, duke marrë në konsideratë deklarinimet e subjektit në deklaratë “Vetting”, siç përshkruhet në tabelën më poshtë:

Analiza financiare për vitin 2011

Të ardhurat nga paga, shpërblimet dhe interesa depozitash	2104366
Hua e marrë	972510
Total mjete monetare të hyra	3076876
Pagesa për vazhën në SHBA, deklaruar	537700
Pagesë për biletë bashkëshortja e subjektit, SHBA	80655
Pagesa të tjera	22250
Pagesat për shpenzime jetese deklaruar	800000
Total shpenzime	1440605
Ndryshim mj. Monetare, gj.01.01.2011 - 31.12.2011	-1651760
Mjete monetare të disponueshme (1)	-15489
Pagesa për blerje pasurie	1982696
Detyrime	0
Pasuri neto (2)	1982696
Balanca e fondeve (1-2)	-1998185

6.23 Komisioni, arsyetoi se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare me dokumentacion ligjor justifikues për blerjen e automjetit, tip “Ford Focus”, në vitin 2011.

6.24 Lidhur me shpjegimet e dhëna nga ana e subjektit të rivlerësimit, Komisioni arsyetoi se:

6.25 Në lidhje me huan e marr nga z. B. Ç, subjektit të rivlerësimit, për të provuar se huadhënësi kishte të ardhura nga burime të ligjshme, paraqiti si provë ekstraktin historik të shoqërisë së krijuar nga huadhënësi, dy dokumente që provojnë se, më datë 13.01.2011, ai ka krijuar shoqërinë “****”, me një kapital prej 10.000.000 lekësh të reja. Më tej, subjekti shpjegoi

se, z. B. Ç, ka depozita të konsiderueshme pranë Bankës Tregtare Kombëtare ose “Raiffesien Bank”, por meqenëse baxhanaku jeton jashtë shtetit (SHBA), unë nuk kam pasur akses në këto banka, për të pasqyruar këto shuma.

✓ *Komisioni në lidhje me këtë provë dhe shpjegim të subjekti arsyeton se dokumentet (ekstrakti historik i shoqërisë “****”) dhe shpjegimet e paraqitura nga ana e subjektit të rivlerësimit nuk justifikojnë ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumës prej 7.000 eurosh dhënë hua nga ana e huadhënësit, z. B. Ç, në vitin 2011.*

Nenet 32, pika 4, e ligjit nr. 84/2016 parashikon se: “Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.”

7. Për aksionet “Bono Privatizimi”¹³, në vlerë 125.000 lekë.

a. Komisioni, për vërtetimin e faktit dhe burimit të të ardhurave, administroi:

7.1 Deklaratën “Vetting” të vitit 2017 dhe dokumentacionin bashkëlidhur.

7.2 Dokumentacionin e administruar nga Agjencia e Prokurimit Publik.¹⁴

7.3 Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

a. Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm.

7.4 Në deklaratë “Vetting” të viti 2017, subjekti i rivlerësimit, deklaroi pasuri “bono privatizimi” në vlerën 125.000 lekë, të përfituara nga bashkëshortja e subjektit në bazë të ligjit të privatizimit, si punonjëse e shoqërisë “ALBtelecom” Tiranë.

7.5 Si burim krijimi, subjekti deklaroi ligjin e privatizimit për punonjësit e “ALBtelecom”.

7.6 Nga hetimi administrativ u konstatua se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/bashkëshortja, kanë plotësuar dy formularë kërkesë për blerje aksionesh për person fizik, konkretisht nr. ***, datë 09.01.2008, me shumën 50.000 lekë (lekë privatizimi) plotësuar nga bashkëshortja e subjektit, si dhe nr. ***, datë 09.01.2008, paguar gjithsej 75.000 (lekë privatizimi), plotësuar nga ana e subjektit të rivlerësimit.

7.7 Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet e dërguara nga subjekti i rivlerësimit dhe deklaratimet e bëra në seancë dëgjimore arrin në përfundimin se:

7.8 Subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tija kanë lidhur kontratë me “ALBtelecom”, institucion publik për blerjen e aksioneve “bono privatizimi”, në shumën 125.000 lekë dhe pse ishte në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit.

7.9 Referuar ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, në nenin 21, pika 1, përcaktohet se: “Asnjë individ, kur ky njësohet me një zyrtar në njërin nga funksionet e përcaktuara në kreun III, seksioni 2 të këtij ligji, gjyqtarët e prokurorët në nivelin e gjykatës së shkallës së parë e në atë të apelit, dhe asnjë shoqëri tregtare, ortakëri a shoqëri e thjeshtë, ku ky zyrtar zotëron, në mënyrë aktive apo pasive,

¹³ Subjekti ka paraqitur pranë ILDKPKI-së: Formular kërkesë për blerje aksionesh nr. *** dhe ***, datë 09.01.2008, me kërkuar L. D, vlera totale 125.000 lekë.
¹⁴ Në ILDKPKI është administruar përgjigjja e Agjencisë së Prokurimit Publik, me shkresën nr. ***prot., datë 27.12.2017, nga e cila rezulton se: Shoqëria “Albelecom” sh.p.k me NIPT ***, është e regjistruar në sistemin SPE dhe është shpallur fitues në procedurat e prokurimit elektronike për periudhën deri në datë.25.1.2017, si dhe në procedurat e prokurimit “Me negociim pa shpallje paraprake të kontratës” si më poshtë:

1. Viti 2009 është shpallur fituese në total në 3 procedura.
2. Viti 2010 është shpallur fituese në total në 3 procedura.
3. Viti 2011 është shpallur fituese në total në 5 procedura.
4. Viti 2012 është shpallur fituese në total në 11 procedura.
5. Viti 2013 është shpallur fituese në total në 29 procedura.
6. Viti 2014 është shpallur fituese në total në 46 procedura.
7. Viti 2015 është shpallur fituese në total në 35 procedura.
8. Viti 2016 është shpallur fituese në total në 61 procedura.
9. Viti 2017 është shpallur fituese në total në 3 procedura.

aksione a pjesë në kapital, në çfarëdo sasive, nuk mund të lidhë kontratë ose nënkontratë me asnjë institucion publik”.

7.10 Në nenin 24, pika 1, të këtij ligji, përcaktohet se: “Rrethi i personave të lidhur me zyrtarin, në zbatim të ndalimeve të përcaktuara në nenin 21 dhe në nenin 22 të këtij ligji, përbëhet nga **bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja fëmijët në moshë madhore dhe prindërit e zyrtarit e të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es**”

7.11 Në interpretim të neneve të sipërcituara rezulton se gjyqtarët në gjykatat e apelit dhe personat e lidhur me ta, nuk mund të lidhin kontrata me institucione publike.

7.12 Në rastin konkret, gjyqtar është subjekti Luan Dervishi, dhe person i lidhur me subjektin është bashkëshortja L. D, e cila është aksionere me 125.000 lekë/125 aksione, në shoqërinë “ALBtelecom” sh.a.

7.13 Një ndalim i tillë është bërë me ligjin nr. 44/2014, datë 24.04.2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike, të ndryshuar”.

7.14 Ky ligj ka hyrë në fuqi, më datë 03.06.2014. Pra sipas ndryshimeve të ligjit, rezulton se çdo kontratë e lidhur me institucione publike, nga data 03.06.2014, është në shkëlqje të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike, me ndryshimet përkatëse”.

7.15 Referuar përgjigjes së Agjencisë së Prokurimit Publik, rezulton se nga data 03.06.2014 deri më datë 25.01.2017, shoqëria “ALBtelecom” sh.a., ku bashkëshortja e subjektit, znj. L. D, është aksionere, me vlerën 125.000 lekë/125 aksione, është shpallur fituese dhe ka lidhur në total 113 kontrata me institucione të ndryshme publike.

7.16 Bazuar në sa më lart arsyetoi, Komisioni, del në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, z. Luan Dervishi, është në situatën e konfliktit të interesit.

7.17 Lidhur me shpjegimet e dhëna nga ana e subjektit të rivlerësimit se: “...ajo nuk ka qenë një veprimtari e mirëfilltë dhe me ndërgjegje nga ana ime për tu angazhuar në një aktivitet biznesi. Nga ana tjetër, rezulton se aksionet e mia në këtë kompani, mbas interesimit tim, kapin një shumë prej 0.0005 %. Por ajo që ka rendësi më shumë është fakti se kompania “ALBtelekom”, prej vitit 2009, ka bilanc negativ .Për t’u shprehur më thjeshtë, prej vitit 2007, unë nuk kam marr asnjë qindarkë nga këto aksione.”

Për sa më sipër, Komisioni, arsyeton se pavarësisht shumës që përfaqësojnë aksionet, bilancit negativ që ka pasur shoqëria “ALBtelekom” prej vitit 2009 si dhe faktit se subjekti nuk ka marrë asnjë fitim nga këto aksione, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij nuk duhej ti kishin lidhur këto kontrata me “ALBtelekom”.

Neni 21, pika 1, e ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Asnjë individ, kur ky njësohet me një zyrtar në njërin nga funksionet e përcaktuara në kreun III, seksioni 2 të këtij ligji, gjyqtarët e prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë e në atë të apelit, dhe asnjë shoqëri tregtare, ortakëri a shoqëri e thjeshtë, ku ky zyrtar zotëron, në mënyrë aktive apo pasive, aksione a pjesë në kapital, në çfarëdo sasive, nuk mund të lidhë kontratë ose nënkontratë me asnjë institucion publik”.

8. Lidhur me vlerën prej 1.100.000 lekësh likuiditet në ‘cash’ gjendje deri më datë 31.12.2016.

a. Komisioni, për vërtetimin e faktit dhe burimit të të ardhurave, administroi:

8.1 Deklaratën “Vetting” të vitit 2017 dhe dokumentacionin bashkëlidhur.

8.2 Deklaratat e interesave private, periodike vjetore të viteve 2013, 2014, 2015 dhe 2016.

8.3 Analiza financiare për likuiditetin në *cash* e përgatitur nga ana e Komisionit.

8.4 Dokumentacioni i administruar nga “Credins Bank.

b. Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm.

8.5 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti ka deklaruar se ka likuiditete në *cash* shumën prej 1.100.000 lekësh, gjendje deri, më datë 31.12.2016.

8.6 Si burim të krijimit për këtë likuiditet, subjekti deklaroi se kjo gjendje është kursyer nga paga për vitet 2013, 2014 dhe 2015 deri, më datë 31.12.2016, në shumën 1.000.000 lekë, çelur depozita bankare pranë “Credins Bank”, më datë 9.12.2016, dhe shumën 100.000 lekë *cash*.

8.7 Nga hetimi administrativ kryesisht, Komisioni konstatoi se, ka mospërputhje në lidhje me burimet të krijimit midis deklaratimeve në deklaratën “Vetting” për vlerën 1.100.000 lekë, gjendje *cash* në datë 31.12.2016, me deklaratat e interesave privatë, periodike vjetore, për vitet 2013, 2014, 2015 dhe 2016.

8.8 Në deklarin periodik të vitit 2016, ka deklaruar çeljen më datë 20.12.2016 të një depozite bankare në “Credins Bank”, me vlerën prej 1.000.000 lekësh *cash*, me burim krijimi: vlera 400.000 lekë kursime nga vitet 2014 - 2015 dhe vlera 700.000 lekë nga viti 2016. Tepricë *cash*, vlera 100.000 lekë.

8.9 Pra depozita bankare në “Credins Bank” është krijuar përpara datës 31.12.2016, duke ulur gjendjen *cash* të akumuluar përpara dhe gjatë vitit 2016 (referuar deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit).

8.10 Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet e dërguara nga subjekti i rivlerësimit dhe deklaratimet e bëra në seancë dëgjimore arrin në përfundimin se:

8.11 Subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm burimin e krijimit të këtyre të ardhurave të deklaruara në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, pasi në deklaratimet e tij kishte mospërputhje për burimin e krijimit të këtij likuiditeti

8.12 Subjekti i rivlerësimit nuk justifikoi me dokumentacion ligjor provues se djali i subjektit kishte mundësi financiare nga burime të ligjshme për të dërguar shumë prej 10.000 UDS.

8.13 Neni D, pika 4, e Aneksit të Kushtetutës parashikon se: “Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore.”

8.14 Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në mënyrë të pasaktë likuiditetin e tij.

8.15 Lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit se shuma prej 5.000 USD, të kursyera nga djali i tij në SHBA, për vitin 2010, fakt i deklaruar dhe i pasqyruar më parë (në deklarin periodik të vitit 2010), i është dorëzuar atij gjatë periudhës verore 2011, kur djali ka ardhur për të shoqëruar vajzën për studime në SHBA. Ndërkohë shuma prej 5.000 USD të tjerë, i janë dorëzuar nga bashkëshortja e subjektit e cila ka qenë për vizitë në SHBA, në muajin nëntor 2011.

✓ *Komisioni për sa më lart arsyeton se, pavarësisht se mund ta marrim të mirëqenë se këto para ja ka sjelle djali, por për efekt të ligjit nr. 842016, këto të ardhura duhet të jenë të ligjshme, pra të jenë paguar detyrimet tatimore. Subjekti i rivlerësimit nuk provoi ligjshmërinë e këtyre të ardhurave. Në këto kushte, këto të ardhura nuk mund të konsiderohen për efekt të analizës financiare të vitit 2011.*

Analiza financiare për vitin 2011

Të ardhurat nga paga, shpërblimet dhe interesa depozitash	2.104.366
Hua e marrë	972.510
Total mjete monetare të hyra	3.076.876
Pagesa për vajzën në SHBA, deklaruar	537.700
Pagesë për biletë bashkëshortja e subjektit, SHBA	80.655
Pagesa të tjera	22.250
Pagesa për shpenzime jetese, deklaruar	800.000

Total shpenzime	1.440.605
Ndryshim mj. monetare gj.01.01.2011 -3 1.12.2011	-1651.760
Mjete monetare të disponueshme (1)	-15.489
Pagesa për blerje pasurie	1.982.696
Detyrime	0
Pasuri neto (2)	1982696
Balanca e fondeve (1-2)	-1998185

9. Lidhur me banesën me sipërfaqe 60 m², në të cilën subjekti banon aktualisht, ndodhur në Tiranë.

a. Komisioni, për vërtetimin e faktit dhe burimit të të ardhurave, administroi:

- 9.1 Deklaratën “Vetting” të viti 2017 dhe dokumentacionin bashkëlidhur.
- 9.2 Dokumentacionin e administruar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.¹⁵
- 9.3 Dokumentacionin e administruar nga “Raiffesen Bank”.¹⁶
- 9.4 Dokumentacionin e administruar nga ZVRPP-ja Tiranë.¹⁷
- 9.5 Kontratën e sipërmarrjes midis shoqërisë “****” sh.p.k., dhe porositeses, znj. M. Sh.
- 9.6 Dokumentin e administruar nga Drejtoria e Gjendjes Civile.¹⁸

b. Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm.

9.7 Në deklaratën “Vetting” të viti 2017, subjekti i rivlerësimit, deklaroi se që prej datës 01.02.2011 nga viti 2011 banon¹⁹ në një apartament me sipërfaqe 60 m², në Tiranë, në pronësi të znj. M. Sh, nënës së personit të lidhur/bashkëshortes.

9.8 Sipas nenit 3, pika 14, e ligjit nr. 84/2016, “*Persona të tjerë të lidhur*” janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, ... që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi.”

9.9 Duke qenë se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën “Vetting” të viti 2017, “Të Dhënat Konfidenciale”, se banon në këtë banesë e cila është në pronësi të znj. M. Sh/nënës së bashkëshortes së subjektit, përcakton se subjekti ka marrëdhënie interesi me znj. M. Sh.

9.10 Referuar në sa më lart, znj. M. Sh, konsiderohet person tjetër i lidhur në kuptim të pikës 14 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, dhe për këtë arsye është subjekti i hetimit administrativ.

9.11 Nga hetimi administrativ kryesisht, Komisioni konstatoi se, në kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.10.2005, me palë sipërmarrëse. shoqëria “****” sh.p.k., dhe palë porositesë, znj. M. Sh, ka pasaktësi në pjesën hyrëse të saj ku përcaktohet se apartamenti do të jetë garsonierë, me sip. 60 m² dhe në nenin 7 se “*përbërja e tij do të jetë dy dhoma, një kuzhinë, dy banja dhe ambiente ndihmëse....*”.

9.12 Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, konfirmon faktin se znj. M. Sh me numër personal ***, figuron të jetë e regjistruar, banore e hershme në zyrën e gjendjes civile të B. M.

9.13 Prej vitit 2009, znj. M. Sh, jeton në SHBA.

9.14 Me prokurën e posaçme, nr. 3188 rep., nr. 2405 kol., datë 08.10.2012, znj. Mejtime Shehu, cakton vajzën e saj, znj. Luljeta Dervishi(bashkëshorten e subjektit të rivlerësimit), që

¹⁵ Shkresa nr. ***prot., datë 16.10.2018, e ISSH-së.

¹⁶ Shkresa nr. *** prot., datë 12.10.2018 “Raiffeisen Bank”.

¹⁷ Shkresa nr. *** prot., datë 17.10.2018, e ZVRPP-së Tiranë.

¹⁸ Shkresa nr. ***, datë 18.10.2018, e DPGJC-së.

¹⁹Subjekti ka paraqitur pranë ILDKPKI-së:

Kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.10.2005, me palë sipërmarrëse shoqëria “****” sh.p.k dhe palë porositesë M. Sh, ku pala sipërmarrëse në apartamentin që ndërton në, Rr. “****”, i shet znj. M. Sh një apartament (garsoniere) me sip. 60 m², me vlerë 30.000 euro;

Prokurë e posaçme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 08.10.2012, ku znj. M. Sh cakton vajzën e saj, znj. L. D, që ta përfaqësojë atë pranë të gjithë institucioneve administrative për tërheqje, nënshkrimin, dorëzim dhe kërkim të çdo lloj dokumenti që lidhen me apartamentin e banimit me sip. 60 m², Rr. “****”, ndërtuar nga shoqëria “****” sh.p.k.

ta përfaqësojë atë pranë të gjithë institucioneve administrative për tërheqje, nënshkrimin, dorëzim dhe kërkim të çdo lloj dokumenti që lidhet me apartamentin e banimit me sip. 60 m², ndodhur në, “Rr. ***”, ndërtuar nga shoqëria “****” sh.p.k., të veprorë në emër e për llogari të saj për të lidhur dhe nënshkruar aktin përfundimtar të shitblerjes së pronës, ka të drejtë të aplikojë pranë ZVRPP-së Tiranë për regjistrimin e kësaj prone, pranë ALUIZNI-t, të lëshimit me qira të pronës duke marrë vlerën e qirasë, caktuar çmimin dhe prishë kontratën. Prokura është pa afat.

9.15 Nga ISSH-ja²⁰ rezulton se shtetësja M. Sh, e datëlindjes 03.08.1944, përfiton pension invaliditeti nga korriku i vitit 1994, në masën aktuale mujore 16.061 lekë.

9.16 Nga “Raiffeisen Bank”²¹, rezulton se znj. M. Sh ka llogari në këtë bankë, me nr. *** në lekë, depozitë e cila, më datë 31.12.2005, rezulton në shumën 415.037 lekë. Kjo depozitë është ridedepozituar deri në vitin 2009, më datë 19.02.2009, është tërhequr *cash* shuma prej 470.875 lekësh. Nga viti 2009 pensioni transferuar nga z. F. Sh.

9.17 Nga ZVRPP-ja Tiranë²² rezulton se, znj. M. Sh, së bashku me të birin, z. S. Sh, kanë të regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme një shtëpi tjetër, pasurinë nr. ***, vol. ***, fq. ***, ZK. ***, lloji i pasurisë apartament me sip. 62,16 m², në bashkëpronësi. E regjistruar pranë ZVRPP-së Tiranë, më datë 28.06.2017.

9.18 Personi i tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit/M.Sh nuk paraqiti dokumentacion justifikues ligjor për të vërtetuar që ka të ardhura të ligjshme për blerjen e këtij apartamenti në shumë prej 30.000 eurosh.

9.19 Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet e dërguara nga subjekti i rivlerësimit dhe deklaratimet e bëra në seancë dëgjimore, arrin në përfundimin se ka dyshime të arsyeshme se subjekti i rivlerësimit është përpjekur të fshehtë këtë pasuri duke e regjistruar në emër të personit tjetër të lidhur/znj. M. Sh, bazuar në sa më poshtë:

- i. Subjekti i rivlerësimit banon tek ky apartament prej 7 vitesh pa ndërprerje dhe pa kundërshtpërblim;
- ii. Administratorët e shoqërise sipërmarrëse “****” sh.p.k., janë të njëjtë me ato që kanë ndërtuar apartamentin tjetër me sipërfaqe prej 125 m² dhe janë persona që kanë lidhje shoqërore me subjektin e rivlerësimit;
- iii. Znj. M. Sh, jeton në SHBA nga viti 2009 dhe nuk kishte asnjë arsye se përse duhet të blinte një pronë të cilën nuk e jep me qira apo nuk jeton vetë aty;
- iv. Prokura pa afat që, znj. M. Sh, i ka lëshuar vajzës së saj/znj. L. D (bashkëshorten e subjektit të rivlerësimit), më datë 8.10.2012, që ta përfaqësojë atë pranë të gjithë institucioneve administrative për tërheqje, nënshkrimin, dorëzim dhe kërkim të çdo lloj dokumenti që lidhet me këtë apartament, të veprorë në emër e për llogari të saj për të lidhur dhe nënshkruar aktin përfundimtar të shitblerjes së pronës, ka të drejtë të aplikojë pranë ZVRPP-së Tiranë, për regjistrimin e kësaj prone, pranë ALUIZNI-t, të lëshimit me qira të pronës duke marrë vlerën e qirasë, caktuar çmimin dhe prishë kontratën.
- v. Znj. Mejtime Shehu, nuk justifikon ligjshmërinë e krijimit të shumës prej 30.000 eurosh që ka blerë këtë apartament as për vete dhe as për djalin, z. S. Sh.
- vi. Znj. Mejtime Shehu, së bashku me të birin, z. S. Sh, kanë të regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme një shtëpi tjetër, apartament me sip.62,16 m² në bashkëpronësi, e regjistruar pranë ZVRPP-së Tiranë, më datë 28.06.2017, ndërkohë që nuk justifikuan ligjshmërinë e krijimit të shumës prej 30.000 eurosh.

10. Për të ardhurat e personit të lidhur/djalit të subjektit, që kanë shërbyer për blerjen e automjetit, tip “Toyota Camry”²³, me vlerë 64.000 USD dhe pagesat për shkollimin e vajzës së subjektit.

²⁰ Shkresa nr. *** prot., datë 16.10.2018, e ISSH-së.

²¹ Shkresa nr. ***prot., datë 12.10.2018, nga “Raiffeisen Bank”.

²² Shkresa nr. ***, datë 17.10.2018, e ZVRP-së Tiranë.

²³ Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur pranë ILDKPKI-së:

a. Komisioni, për vërtetimin e faktit dhe burimit të të ardhurave, administroi:

- 10.1 Deklarimet e bërë nga ana juaj pranë ILDKPKI-së.
- 10.2 Deklaratën “Vetting” të vitit 2017 dhe deklaratat vjetore nga viti 2003 - 2016.
- 10.3 Provat shkresore të administruara nga ana e ILDKPKI-së.
- 10.4 Dokumentacioni i dorëzuar nga ana juaj pranë ILDKPKI-së dhe Komisionit.
- 10.5 Provat shkresore të administruara nga ana e Komisionit në dosje nga institucionet publike dhe private.
- 10.6 Deklarimet tuaja dhënë Komisionit me anë të përgjigjeve të pyetjeve me anë të postës elektronike.

b. Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm.

10.7 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, personi i lidhur/djali i subjektit të rivlerësimit deklaroi se ka blerë një automjet të markës “Toyota Camry”, me vlerë 64.000 USD, me burim krijimi kredinë tek “American Lease” Brooklyn NY USA, datë 15.11.2014.

10.8 Nga hetimi administrativ kryesisht, u konstatua se:

10.9 Personi i lidhur/djali i subjektit të rivlerësimit jeton dhe banon SHBA.

10.10 Ai ka marrë me qira financiare (leasing) në shumën prej 64.000 USD²⁴, më datë 15.11.2014, te shoqëria “American Lease Brooklyn NY”., e cila rezultoi se ka shlyer si më poshtë:

- ✓ Vlerën 2.950,34 USD, shlyer deri më datë 31.12.2014.
- ✓ Vlerën 18.226,93 USD, shlyer, deri më datë 31.12.2015.
- ✓ Vlerën 14.854,38 USD, shlyer deri me dt. 18.10.2016.
- ✓ Shuma e detyrimit e mbetur pa shlyer deri me dt. 11.5.2018, në vlerën 27.968,35 USD.

10.11 Sipas formularëve të pagimit të taksës mbi të ardhurat personale në SHBA (US Individual Income Tax Return) për periudhën 2010 - 2016, protokolluar në Komisionit, nr. *** prot, datë 02.10.2018, si dhe dokumentacionit për shlyerjen e qirasë financiare “Leasing” të dërguar nga subjekti në dosjen e ILDKPKI-së, rezultojnë këto të ardhura dhe pagesa për autoveturën:

Të ardhura i biri SHBA	
Periudha	Vlera në USD
2010	3.735
2011	10.981
2012	7.448
2013	9.575
2014	840
2015	2.376
2016	12.289

Licencë taxi për z. E. D, lëshuar më datë 11.10.2014, nga Komisioni i Taksave New York, me afat deri me datë 11.7.2016 dhe licencë me afat deri me datë 02.10.2017.

Dokumentacion të ardhurash (Taxex) në SH.B.A, për z. E. D, vitet 2013 - 2015 (viti 2013 e ardhura totale bruto 20.812 USD, viti 2014, e ardhura totale bruto 29.280 USD, viti 2015 e ardhura totale bruto 48.108 USD).

²⁴ Subjekti ka paraqitur pranë ILDKPKI-së: “Payment Statement EZ Livery Leasing LLC”, vlera totale e paguar për vitin 2014 është 2.950 USD, për vitin 2015 është 18.226 USD, për vitin 2016 është 14.854 USD, në total 36.030 USD.

Dokumentacioni i dërguar nuk është i plotë për këto arsye se për vitin 2009 nuk ka informacion për të ardhurat; të ardhurat e evidentuara në deklaratimet vjetore të taksave në USA janë paraqitur në vlerën bruto si dhe viti 2015 nuk është dokument i plotë dhe i qartë.

10.12 Të ardhurat referuar këtyre formularëve janë shumë të ulta krahasuar me (i) deklaratimet e subjekti të rivlerësimit në periudhat përkatëse, si dhe

10.13 Referuar të dhënave të dërguara nga subjekti, konkretisht formularët “Payment Card and Third Party Network Transactions”, në të cilat për z. E. D janë këto të dhëna:

Periudha	Vlera e të ardhurave bruto në USD
2013	20.813
2014	29.280
2015	48.108

10.14 Në deklaratën vjetore të vitit 2015, personi i lidhur/djali i subjektit deklaroi se ka paguar detyrim për shkollën e personit të lidhur/vajzës së subjektit në shumë 15.000 USD.

10.15 Në deklaratën vjetore të viteve 2012 dhe 2013, personi i lidhur/djali i subjektit nuk ka deklaruar të ardhurat e përfituara për këtë vit.

10.16 Ka mospërputhje në lidhje me të ardhurat e përfituara nga personi i lidhur/djali i subjektit midis deklaratimit të bërë në vitin 2014 pranë ILDKPKI-së (deklaruar 25.000 USD) dhe formularëve individualë mbi tatimin për të ardhurat personale (deklaruar 7448 USD bruto).

10.17 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, personi i lidhur/djali i subjektit nuk ka deklaruar të ardhurat e përfituara për tërë periudhën e punësimit.

10.18 Nuk ka informacion për shpenzimet e personit të lidhur djalit të subjektit, si dhe cila është vlera respektive që ka paguar dhe kontribuar djali për shkollën e motrës dhe jetesës së saj. (vlera të cilat janë deklaruar nga subjekti në përgjigje të pyetësorit).

10.19 Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit dhe deklaratimet e bëra në seancë dëgjimore, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm burimin dhe ligjshmërinë e të ardhurave të personit të lidhur/djalit të tij për pagimin e kredisë së blerjes së makinës në shumë prej 64.000 USD, sipas kësteve të pagesës.

10.20 Neni D, pika 4, të Aneksit të Kushtetutës parashikon se: “Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë binshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore.”

10.21 Personi i lidhur/djali i subjektit të rivlerësimit nuk arriti të provojë me dokumentacion ligjor justifikues ligjshmërinë e të ardhurave që kanë shërbyer për të shlyer këstet e kredisë financiare të automjetit, tip “Toyota Camy”, si dhe shumën prej 15.000 USD për pagesën e shkollës së personit të lidhur/vajzës së subjektit.

10.22 Lidhur me shpjegimet e dhëna nga ana e subjektit të rivlerësimit se: personi i lidhur/djali i tij ka punuar në SHBA, për disa nga shërbimet që ka kryer u është shmangur pagimit të taksave direkt apo detyrimeve të tjera, përveç punës së kryer në shoqëritë “*” dhe “****”.**

10.23 Për sa më sipër, Komisioni arsyeton se subjekti i rivlerësimit e pranon dhe vetë se të ardhurat e djalit nuk kalojnë testin e nenit D, pika 4 të Aneksit të Kushtetutës, në këto kushte ato nuk konsiderohen për efekt analize financiare si të ardhura të ligjshme.

11. Për të ardhurat dhe shpenzimet e personit të lidhur/vajzës së subjektit të rivlerësimit – A. D.

a. Komisioni, për vërtetimin e faktit dhe burimit të të ardhurave, administroi:

- 11.1** Deklaratën “Vetting” të vitit 2017 dhe dokumentacioni bashkëlidhur.
- 11.2** Deklarimet në deklaratat e interesave private, periodike vjetore nga viti 2003 -2016.
- 11.3** Dokumentacioni i dorëzuar nga ana juaj pranë ILDKPKI-së dhe Komisionit.
- 11.4** Provat shkresore të administruara nga ana e Komisionit në dosje nga institucionet publike dhe private.
- 11.5** Deklarimet tuaja dhënë Komisionit me anë të përgjigjeve të pyetjeve me anë të postës elektronike.

b. Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm.

11.6 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, personi i lidhur/vajza e subjektit ka deklaruar se është e punësuar në kompaninë “****”²⁵, filluar më datë 19.09.2016, me pagë mujore 3.070 USD dhe deklaroi të ardhura neto të përfituara në shumën prej 3.000 USD.

11.7 Në deklarinimin periodik të vitit 2016 nga personi i lidhur/vajza e subjektit ka deklaruar si shumë e të ardhurave neto, vlera 20.800 USD me përshkrim e punësuar si analiste e shitjeve për vitin 2016.

11.8 Nga hetimi administrativ kryesisht, Komisioni konstatoi se, nga dokumentacioni i dërguar nga subjekti, nga viti 2012 - 2016, personi i lidhur/vajza e subjektit ka kryer studimet në universitet. Sipas deklarimeve të subjektit, personi i lidhur/vajza e subjektit ka filluar studimet (sistemi 4-vjeçar) në shkollën e Lartë Private -“Pace University “New-York Manhattan” në SHBA dhe në vitin 2014, vazhdon studimet, transferohet tek shkolla publike,”Binghamton University “Qyteti Binghamton”, New-Yok, SHBA.

11.9 Referuar dokumentacionit të dërguar, më datë 13.11.2018m nga subjekti i rivlerësimit, vajza e subjektit ka përfituar bursë përkatësisht për periudhën vjeshtë 2012 në vlerë 7.500 USD, për periudhën pranverë 2013 shumën 7.500 USD, si dhe për periudhën vjeshtë 2013 shumën 7.500 USD. Në total për vitin 2013 shuma e përfituar është 15.000 USD.

11.10 Referuar dokumentacionit të mësipërm rezultoi se detyrimi për t’u paguar në total, bursa dhe shuma e paguar janë siç përshkruhen në tabelën më poshtë:

Periudha	Shuma totale		Shuma e paguar	
	USD	Bursë USD	USD	
2012	19278	7500		11778
2013	37669	15000		22669

11.11 Subjekti i rivlerësimit ka dërguar dokumentacion, për periudhën që vajza ka vazhduar “Universitetin Binghamton”, nga i cili konstatohet se:

- ✓ Në datë 06.02.2014, detyrimi ka qenë 75 USD.
- ✓ Në datë 04.08.2014, detyrimi ka qenë 10.781,35 USD.
- ✓ Në datë 05.01.2015, detyrimi ka qenë 7.121,89 USD.
- ✓ Në datë 03.08.2015, detyrimi ka qenë 11.793.85 USD.
- ✓ Në datë 04.01.2016, detyrimi ka qenë 11.970.5 USD.

11.12 Sa më sipër vajza ka pasur detyrim në total për vitet respektive ndaj universitetit si më poshtë:

Periudha	Detyrim totale USD
2014	10.856,35
2015	18.915,64

²⁵ Subjekti ka paraqitur pranë ILDKPKI-së: Ofertë Pune ***, datë 19.09.2016, me vlerën 767.55 USD bruto në javë dhe pranim kërkesë për znj. A. D.

2016

11.970,5

11.13 Më tej, për efekt përputhshmërie të deklaramit periodik të subjektit të rivlerësimit, ku deklarohet se pagesat janë kryer në monedhën lekë për studimin e vajzës, Komisioni, ka bërë konvertimin e monedhës dollar në atë lekë referuar kursit vjetor përkatës sipas Bankës së Shqipërisë, si më poshtë:

Periudha	Detyrim totale	
	USD	Vlera në lekë
2012	11.778	1.246.701,3
2013	22.669	2.309.064,34
2014	10.856,35	1.250.977,211
2015	18.915,64	2.379.398,356
2016	11.970,5	1.535.695,445
Total	76.189,49	8.721.836,651

11.14 Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit dhe deklaramet e bëra në seancë dëgjimore, arrin në përfundimin se, personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit/vajza e tij ka bërë deklaram të pasaktë të të ardhurave të saj në deklaramtën “Vetting” të vitit 2017, pasi ka mospërputhje të shumën së të ardhurave krahasuar ve deklaramin e bërë në deklaramtën e interesave private, periodike vjetore 2016.

11.15 Subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion ligjor provues pagesën e kryer pranë “Universitetit Binghamton” për një semestër. Kështu që nuk është e qartë se sa ka qenë shumta e paguar për shkollimin e vajzës në këtë universitet.

11.16 Subjekti i rivlerësimit ka fshehur shpenzimet reale të shkollimit të vajzës, ku sipas dokumentacionit rezultoi 8.721.836,651 lekë, ndërkohë që subjekti ka deklaram vetëm 5.128.950 lekë. Për më shumë referohu tabelës më poshtë:

Periudha	Detyrim totale		Deklaruar nga subjekti për studimet
	USD	Vlera ne .Leke	
2012	11778	1246701,3	1500000
2013	22669	2309064,34	1500000
2014	10856,35	1250977,211	1500000
2015	18915,64	2379398,356	628950
2016	11970,5	1535695,445	0
Total	76189,49	8721836,651	5128950

11.17 Subjekti i rivlerësimit ka deklaram të rremë dhe jo në përputhje me ligjin në lidhje me burimin e financimit të studimeve të vajzës pasi në deklaramet periodike të viteve 2012, 2013, 2014, subjekti deklarohet se i ka financuar nga të ardhurat e tij ndërsa referuar deklarameve të subjektit si pjesë të përgjigjeve të pyetësorit, shpenzimet për këtë periudhë në lidhje me studimet janë mbuluar nga kontributi i djalit dhe në mënyrë modeste nga të ardhurat që siguronte vajza në fundjavë.

11.18 Si konkluzion, subjekti i rivlerësimit ka deklaram në mënyrë të rremë shpenzimet e kryera për shkollimin e vajzës duke I paraqitur ato në mënyrë të pasaktë.

12. Lidhur me të ardhurat e deklaramuara nga subjekti i rivlerësimit në deklaramtën “Vetting” të vitit 2017.

12.1 Në deklaramtën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaram të ardhurat e tij, të bashkëshortes dhe personit të lidhur/djalit të subjekti në shumën totale prej 36.848.148 lekësh.

12.2 Nga hetimi administrativ kryesisht, Komisioni konstatoi se, të ardhura me dokumentacion justifikues ligjor, sipas ligjit nr. 84/2016 dhe Kushtetutës janë në shumën 31.672.748 lekë.

12.3 Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit dhe deklaratimet e bëra në seancë dëgjimore, arrin në përfundimin se, subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion ligjor të ardhurat në shumën prej 5.175.400 lekë (si diferencë e të ardhurave të deklaruara në shumën 36.848,148 lekë me shumë e të ardhurave me dokumentacion justifikues ligjor në shumën prej 31672748 lekësh) siç përshkruhet në tabelën më poshtë:

TË ARDHURAT			
NR	PËRSHKRIMI	SHUMA E TË ARDHURAVE NETO të deklaruara	SHUMA E TË ARDHURAVE NETO me dokumentacion justifikues
SUBJEKTI		lekë	lekë
	Të ardhurat nga paga në Gjykatën e Apelit Shkodër	14707195	14707195
	Inspektor në Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë	8292222	8292222
	Avokat	0	s'ka dokumentacion justifikues
	Gjyqtar në gjykatën Elbasan	95409	95409
	Gjyqtar në Gjykatat Tepelenë dhe Librazhd	0	s'ka dokumentacion justifikues
	Përmbaues /Gjykata Përmet	0	
		23094826	23094826
Bashkëshortja	Pagesë papunësie / asistencë specialiste finance në "Alb telekom"	82200	82200
	Kr/ degës së financës në DRSS-së Elbasan	8079298	8079298
	Kr/ e degës së financës postës Librazhd	246406	246406
	Kr/ e degës së financës postës Librazhd	170018	170018
	Llogaritare në NT Librazhd	0	s'ka dokumentacion justifikues
	Ekonomiste në Ndërmarrjen e Furnizimit Memaliaj	0	s'ka dokumentacion justifikues
		8577922	8577922
personi i lidhur/djali	Të ardhura nga puna 10.000 USD cash	1075400	
		1075400	0
Te tjera	Të ardhura nga shitja e banesës (nga privatizimi) ne Librazhd më datë 24.11.1997	900000	s'ka dokumentacion për pagesë detyrimesh
	Te ardhura nga shitja e objektit Zyrë Avokatie ne Librazhd	500000	s'ka dokumentacion për pagesë detyrimesh
	Të ardhura nga qiraja e garazheve në vitin 2013	550000	s'ka dokumentacion për pagesë detyrimesh
	Të ardhura nga qiraja e garazheve në vitin 2014	550000	s'ka dokumentacion për pagesë detyrimesh
	Interesa bankare (banka e kursimeve) 1997 - 2001	1300000	s'ka dokumentacion për pagesë detyrimesh
	Të ardhura nga qiraja e garazheve viti 2004-2005	300000	s'ka dokumentacion për pagesë detyrimesh

		4100000	
	TOTAL (I+II)	36848148	31672748

12.4 Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se nuk është dakord me përfundimet e mësipërme, me arsyetimin se ne te gjitha kolonat, me shifrën 0, ose ku është vënë shënimi “s’ka dokumentacion për pagim detyrimesh”, për të cilat ju keni kërkuar burimin e te ardhurave të familjes së tij, nuk është i pranueshëm, për shkak se nuk duhet të mohohet veprimi juridik i kryer.

✓ *Komisioni për sa më lart, arsyeton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, nuk paraqitën dokumentacion ligjor justifikues për të vërtetuar deklaratimet e tyre, si dhe nuk provuan pamundësinë objektive për të dërguar këtë dokumentacion.*

Neni 32, pika 1, e ligjit nr. 84/2016 parashikon se: *“Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklaratimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.”*

Si dhe neni 32, pika 2, e ligjit nr. 84/2016 parashikon se: *“Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t’i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme. Ky rregull zbatohet edhe në ato raste kur organi përgjegjës për lëshimin e dokumenteve justifikuese nuk përgjigjet brenda afatit ligjor.”*

13. Për analizimin financiar të deklaratimeve ndër vite të subjekti të rivlerësimit

Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi deklaratat e interesave private ndër vite, arrin në përfundimin se:

13.1 Subjekti i rivlerësimit ka deklarim të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin për sa i përket kursimeve **të vitit 2005.**

13.2 Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar shtesat në llogarinë e pagës në “Raiffeisen Bank” në emër të tij në vlerën 267.335 lekë, në deklarimin periodik **të vitit 2006.**

13.3 Subjektit i rivlerësimit ka fshehur depozitat pranë “Credins Bank”, në emër të bashkëshortes në vlerë totale 2.002.000 lekë, më datë 31.12.2007, në deklarimin periodik **të vitit 2007.**

13.4 Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar depozitën në lekë në vlerë **1.857.717 lekë** pranë “Raiffeisen Bank”, **në vitin 2008.** Gjithashtu në po të njëjtin vit, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar se nga llogaria e bashkëshortes në USD nr. ***, janë kryer 5 transfera me jashtë në vlerë totale 19.692.25 USD, prej të cilave shuma 13.672.25 USD ka pasur përfitues, znj. E. D, ndërsa shuma 6020 USD është transferuar në llogari të z. A. M dhe znj. D. Sh, më datë 04.08.2008, sipas të dhënave të “Credins Bank”.

13.5 Në deklarimin periodik të vitit 2012, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në rubrikën “Detyrime” në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012 shuma e huas së pashlyer e marrë në vitin 2011 në vlerën 7.000 euro.

13.6 Në deklarimin periodik të vitit 2013, subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mjete monetare për të justifikuar krijimin e pasurive, shtesat në likuiditete dhe shpenzimet e deklaruara, si më poshtë vijon:

Analiza financiare për vitin 2013

Të ardhurat nga paga, shpërblimet dhe interesa depozitash	2187910
Total mjete monetare te hyra	2187910
Pagesë hua	500000
Pagesë studimi deklaruar	1500000
Pagesa pushime	308462
Pagesat për shpenzime jetese deklaruar	750000
Total shpenzime	3058462
Ndryshim mj. monetare gj.01.01.2013 - 31.12.2013	-183540
Mjete monetare të disponueshme (1)	-1054092
Pagesa për blerje pasurie	0
Detyrime	0
Pasuri neto (2)	0
Balanca e fondeve (1-2)	-1054092

13.7 Në deklarimin periodik të vitit 2014, subjekti i rivlerësimit :

- i. Nuk ka deklaruar dhe paguar tatimin mbi qiranë.
- ii. Nuk është deklaruar transferimi i shumës 438.544 lekë me përshkrimin “kalim page muaji gusht 2014” pranë “BKT”-së.²⁶;
- iii. Nuk është deklaruar se në llogarinë në USD të bashkëshortes së subjektit pranë kësaj banke, është depozituar *cash* shuma prej 9.025 USD, në datë 03.01.2014, dhe në të njëjtën ditë është transferuar në llogari të djalit në USA shuma prej 9.000 USD.
- iv. Rezulton se për vitin e mbyllur 2014, subjekti nuk ka pasur mjete monetare për të justifikuar krijimin e pasurive, shtesat në likuiditete dhe shpenzimet e deklaruara.

Analiza financiare për vitin 2014

Të ardhurat nga paga, shpërblimet dhe interesa depozitash	2499745
Total mjete monetare të hyra	2499745
Pagesë hua	472510
Pagesë studimi deklaruar	1500000
Pagesat për shpenzime jetese	700000
Total shpenzime	2672510
Ndryshim mj. monetare gj.01.01.2014 - 31.12.2014	-324161
Mjete monetare të disponueshme (1)	-496926
Pagesa për blerje pasurie	0
Detyrime	0
Pasuri neto (2)	0
Balanca e fondeve (1-2)	-496926

13.8 Ka mospërputhje ndërmjet deklarimeve periodike vjetore të viteve 2014 dhe 2015, në vitin 2014, nuk deklarohet kursime *cash*, ndërsa në vitin 2015 deklarohen kursime nga viti 2013 dhe 2014 në vlerë 400.000 lekë (referuar deklarimit në vitin 2013 shuma e kursyer është shtesa gjendje *cash* në vlerë 200.000 lekë).

²⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 18.09.2018.

13.9 Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se nisur nga fakti se burimet e të ardhurave të familjes së tij janë transparente, fakti se përqindjen, pothuaj tërësisht, e zënë të ardhurat nga puna, deklararon se këto të ardhura, për të gjithë periudhën objekt verifikimi nga Komisioni i “Vettingut”, i mbulojnë çfarëdo shpenzime që ai ka kryer. Duke u nisur nga kjo bindje, subjekti deklaroi se ka qenë i pakujdesshëm në pasqyrimin apo deklarimin korrekt të tyre.

✓ *Komisioni në sa më sipër subjekti deklaroi, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dhe pse pranon pakujdesinë në deklarimin korrekt të tyre, nuk provoi me dokumentacion ligjor provues se këto probleme në deklarim ishin të karakterit pasaktësi apo harresë.*

Sipas nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar “Afati dhe objekti i deklarimit”, parashikon se: “Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të interesave private, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë:

a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil;

b) pasuritë e luajtshme, të regjistrueshme në regjistrat publikë, dhe të drejtat reale mbi to sipas Kodit Civil;

c) sendet me vlerë të veçantë mbi 300 000 (treqind mijë) lekë;

ç) vlerën e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim;

d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në cash jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj;

dh) detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, të shprehura në lekë ose në valutë të huaj;

e) të ardhurat personale për vitin, nga paga ose pjesëmarrja në borde, komisione ose çdo veprimtari tjetër që sjell të ardhura personale;

ë) licencat dhe patentat që sjellin të ardhura.

f) dhuratat dhe trajtimet preferenciale, përfshirë identitetin e personit fizik ose juridik, prej nga vijnë apo krijohen dhuratat a trajtimet preferenciale. Nuk deklarohen dhurata ose trajtim preferencial kur vlera e tyre është më e vogël se 10 000 (dhjetë mijë) lekë, si dhe kur dy e më shumë dhurata ose trajtime preferenciale, të dhëna nga i njëjti person, së bashku, nuk e kalojnë këtë vlerë, gjatë së njëjtës periudhë deklarimi;

g) angazhime në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie që krijon të ardhura, përfshirë çdo lloj të ardhure, të krijuar nga kjo veprimtari ose ky angazhim;

gj) interesa privatë të subjektit, që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga marrëdhëniet familjare apo të bashkëjetesës;

h) çdo shpenzim i deklarueshëm, me vlerë mbi 300.000 (treqind mijë) lekë, i kryer gjatë vitit të deklarimit.

Interesat privatë të llojeve të tjera nga ato të përcaktuara në nenin 4 të këtij ligji mund të kërkojnë të deklarohen periodikisht, nëse kjo është e mundur dhe e përshtatshme për nënloje interesash brenda këtyre llojeve, të përcaktuara me urdhër të Inspektorit të Përgjithshëm.

VI. KONTROLLI I FIGURËS

1. Deklarata për Kontrollin e Figurës, sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, është plotësuar nga subjekti i rivlerësimit brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e ligjit dhe është dërguar në DSIK, sipas parashikimeve të nenit 35 të ligjit nr. 84/2016.

2. Me shkresën nr. * prot., datë 18.09.2018, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK)** ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti

i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

3. DSIK-ja ka dërguar një raport të arsyetuar, të deklasifikuar me vendimin nr. ***, datë 21.09.2018, të KDZh-së, duke konkluduar mbi: “*Papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Luan Dervishi*”, për shkak se për subjektin e rivlerësimit, z. Luan M. Dervishi, disponohen të dhëna [REDACTED] ku për këtë të fundit ngrihen dyshime për përfshirje në veprime korruptive, gjatë gjykimit të një çështje penale.

4. Më tej DSIK-ja shprehet se në frymën kundër korrupsionit të ligjit nr. 84/2016 se integriteti profesional është element përcaktues për pastërtinë e figurës të subjektit të rivlerësimit. Dyshimet e ngritura për rastin në fjalë, [REDACTED] e vërtetojnë përfshirjen e subjektit të rivlerësimit në veprimtari korruptive.

5. Në shtjellim të pikës a, argumentohet se informacioni që disponohet në ngarkim të subjektit të rivlerësimit, z. Luan Dervishi, për implikim në veprimtari korruptive të funksionarit të drejtësisë, në formën e mitmarrjes, për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën e tij funksionale, e bën subjektin në fjalë person me tendencë për përfshirjen në veprimtari kriminale, vlerësim i mbështetur në pikat b dhe c, të nenit 37 të ligjit nr. 84/2016.

6. Bazuar në nenin 38 të ligjit nr. 84/2016, ligjvënësi i është referuar kontakteve të papërshtatshme që mund të ketë subjekti i rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Nisur nga qëllimi dhe fryma e ligjit, ku procesi i rivlerësimit përfshin kontrollin tërësor të prokurorëve dhe gjyqtarëve duke filluar nga vetë subjekti e më pas duke zbuluar ose identifikuar lidhjet e subjekteve me krimin e organizuar, rrjedhimisht subjekti i rivlerësimit është subjekt i kontrollit të ligjit dhe i përfshirjes ose jo në krimin e organizuar.

7. Informacioni që disponohet në ngarkim të subjektit të rivlerësimit për veprimtari korruptive, e vërteton rrethanat e konstatimit të faktit se ekziston një kontakt i papërshtatshëm me person/persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas përcaktimit të pikës 15, të nenit 3, të këtij ligji, në formën e shkëmbimit të parave, favore apo dhuratave, në papajtueshmëri të plotë me detyrën, si dhe sipas përcaktimit të pikës 8 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, që përfshin veprat penale të cilat bazuar në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale, subjekti i rivlerësimit është përfshirë në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formën e korrupsionit aktiv dhe pasiv të gjyqtarit.

8. Mbështetur në pikat e lartpërmendura dhe mbështetur në nenin 3, pika 8, nenin 37, germa b dhe c, nenin 38, pika 6, germa b, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Grupi i Punës rishikon konstatimin fillestar të kontrollit të figurës të subjektit të rivlerësimit, z. Luan Dervishi, dhe arrin në përfundimin mbi papërshtatshmërinë e vijimit të ushtrimit të detyrës nga ky subjekt.”

9. **Komisioni i bëri të ditur subjektit të rivlerësimit konstatimin e rishikuar të DSIK-së në lidhje me papërshtatshmërinë e tij për vazhdimin e detyrës dhe subjekti i rivlerësimit shpjegoi se, në mënyrë të prerë nuk ishte dakord dhe se nuk mund ta pranonte një përfundim të tillë, për faktin se gjatë gjithë periudhës së jetës së tij në Drejtësi, nga viti 1982 e vijim, nuk ka pasur asnjë indice apo të ketë marrë ndonjë vërejtje, qoftë nga organet e drejtësisë, apo nga institucione të tjera shtetërore, lidhur me ushtrimin e aktivitetit të tij.**

10. Subjekti e konsideron aspektin e figurës më të rëndësishmin nga të tre komponentët, për ndjeshmërinë e lartë që krijon, për këtë arsye shprehet se është gjeja më e thjeshtë dhe më e domosdoshme që të ketë një minimum informacioni, lidhur me faktin e akuzuar, për të krijuar një mbrojtje sa me efektive.

11. Ai më tej shprehu se i është drejtuar Komisionit përkatës të “Vettingut” lidhur me këtë fakt dhe i është dhënë një dokument i cili ka të njëjtën përmbajtje si ai i prezantuar në relacionin e seancës dëgjimore si dhe i është kthyer përgjigje nga ana e Komisionit se nuk ka informacion tjetër, përveç atij që i është bërë e njohur subjektit.

12. Në këto kushte subjekti deklaroi se nuk mund të ketë asnjë opinion apo kontestim për konstatimin e Grupit të Punës, pranë Drejtorisë së Informacionit të Klasifikuar (DSIK-së).

13. Komisioni ,bazuar në provat që dokumentet që disponon dhe vlerësimin e çështjes në tërësi në lidhje me kriterin e figurës, arrin në përfundimin, se subjekti i rivlerësimit nuk rezulton me probleme serioze gjatë kontrollit të figurës pasi në raportin e dërguar nga ana e DSIK-së vlerësimi i kryer nuk përmban rrethanat që merren parasysh në konstatimin se ekziston një kontakt i papërshtatshëm me një person të përfshirë në krimin e organizuar, dhe prandaj Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

14. Në këto kushte, Komisioni çmon se konstatimet në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës nuk mund të konsiderohen si shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit sipas nenit 61, pika 2, të ligjit nr. 84/2016.

VII. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

1. Bazuar në faktet e njohura botërisht dhe informacionet të tjera nga Ministria e Drejtësisë

a. Komisioni për vërtetimin e faktit u bazua në:

1.1 Raporti “Mbi inspektimin e kryer në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe Gjykatën e Apelit Shkodër”, në korrik 2015.

1.2 Shkresa nr. *** prot., datë 10.12.2015, dhe nr. *** prot., datë 11.12.2015, “Observacione të gjyqtarit Luan Dervishi”.

1.3 Artikujt në media të ndryshme në kohën kur ndodhi ngjarja.

1.4 Ligjin nr. 96/2016 ‘Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë’

b. Arsytimi ligjor në lidhje me ligjin e zbatueshëm

1.5 Nga informacionet e publikuara në media, është bërë publike se Gjykata e Apelit Shkodër, pjesë e së cilës ka qenë edhe subjekti i rivlerësimit, z. Luan Dervishi, vendosi ndryshimin e vendimit për të pandehurin S. M, nga 10 vjet burg me 4 vjet burg, pas apelit që bëri pala mbrojtëse.

1.6 Ngjarja e rëndë e ka filluesën në shtator të vitit 2010, kur në Komunën *** të Dukagjinit u vra me mjete të forta 13-vjeçari A. L, i cili po kulloste bagëtinë. M. ishte 15 vjeç, kur mori pjesë në vrasjen makabër të një vogëlushi vetëm 13 vjeç, ku bashkë me 2 persona të tjerë i morën varësen dhe e torturuan deri në vdekje.

1.7 Dy pjestarët e tjerë ende vijojnë të mbeten në burg, teksa M., nga 10 vjet dënim që mori fillimisht nga Gjykata e Shkallës së Parë në Shkodër, u dënua me 4 vjet nga Gjykata e Apelit. Vendimi i Gjykatës së Apelit është firmosur nga gjyqtarët M. H., F. V dhe Luan Dervishi. Më pas ai la qelitë e burgut, për të kryer vrasjen e çiftit çek.

1.8 Në lidhje me këtë konstatim, është dërguar kërkesë për informacion, nr. *** prot., datë 03.10.2018, Ministrisë së Drejtësisë për subjektin e rivlerësimit, z. Luan Dervishi, lidhur me rezultatin e inspektimit të kryer në Gjykatën e Apelit Shkodër për çështjen penale në ngarkim të të gjykuarit S. M.

1.9 Bashkëlidhur shkresës nr. ***, datë 04.10.2018, nga Ministria e Drejtësisë janë dërguar:

- i. Urdhri i Ministrit të Drejtësisë, nr. *** prot., datë 06.07.2015;
- ii. Raporti “Mbi inspektimin e kryer në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe Gjykatën e Apelit Shkodër” në korrik 2015;

- iii. Shkresa nr. ***prot., datë 24.11.2015, e Ministrisë së Drejtësisë, me anë të së cilës i është përcjellë Raporti i Inspektimit, gjyqtarit Luan Dervishi;
- iv. Shkresa nr. *** prot., datë 07.07.2015, e Ministrisë së Drejtësisë, nëpërmjet së cilës informohet IKLD-ja, se Ministria e Drejtësisë po zhvillon inspektim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe Gjykatën e Apelit Shkodër;
- v. Shkresa nr. *** prot., datë 10.12.2015, dhe nr. *** prot., datë 11.12.2015, “Observacione të gjyqtarit Luan Dervishi”;
- vi. Materialet/dosjet objekt inspektimi, të tërhequra nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe Gjykata e Apelit Shkodër.

1.10 Në raportin mbi inspektimin e kryer në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe Gjykatën e Apelit Shkodër në korrik 2015 përcaktohet se gjatë këtij inspektimi u kontrollua veprimtaria procedurale penale dhe administrative e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe Gjykatës së Apelit Shkodër, në gjykimin e çështjeve penale me të pandehur S. M.

1.11 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 28.12.2011, ka vendosur ndër të tjera: *“Deklarimin fajtor të të pandehurit S. M për kryerjen e veprës penale të “Vrasjes së kryer në rrethana të cilësuar”, të kryer ndaj të miturit në bashkëpunim, dhe në bazë të neneve 79/a -25 dhe 51 të Kodit Penal, dënimin e tij me 10 vjet burgim.....”*

1.12 Kundër këtij vendimi është ushtruar ankim nga të pandehurit dhe avokatët e tyre. Gjykata e Apelit Shkodër në përfundim të gjykimit, me vendimin nr. ***, datë 04.01.2013, ka vendosur për të pandehurin S. M, ndryshimin e vendimit: (i) Deklarimin fajtor të të pandehurit për kryerjen e veprës penale të sigurimit të kushteve për të kryer vrasje dhe në bazë të nenit 80 e 52 të Kodit Penal e dënon me 2 vjet e gjashtë muaj burgim; (ii) Deklarimin fajtor të pandehurit për veprën penale të “Moskallëzimit të krimit” dhe në bazë të nenit 300 e 51 të Kodit Penal e dënon me 1 vit e 6 muaj burgim. Në zbatim të nenit 55 të Kodit Penal e dënon përfundimisht të pandehurin **me 4 vjet burgim.**

1.13 Gjykimi i kësaj çështjeje ka zgjatur për një periudhë kohore prej 10 muaj e 21 ditë nga momenti i kalimit të çështjes me short, pra jashtë afatit 9 mujor të përcaktuar në vendimin e KLD-së, nr. ***, datë 14.04.2010.

1.14 Të gjitha seancat gjyqësore kanë filluar me vonesë, pa u pasqyruar në procesverbal shkaku i fillimit të tyre me vonesë duke shkelur Kodin e Etikës Gjyqësore, miratuar nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare, më datë 08.12.2006, rregullin 8 të saj, nenin 4 të Vendimit të KLD-së, nr. ***, datë 24.12.2008. Kjo praktikë e gabuar ka sjellë për pasojë uljen e transparencës së zhvillimit të gjykimeve në këtë gjykatë.

1.15 Gjykata në arsyetimin e saj citon se i pandehuri S. M nuk ka bashkëpunuar në vrasje, por u ka krijuar kushte dy të pandehurve të tjerë për ta kryer atë dhe duhet të përgjigjet për veprën penale të parashikuar nga neni 80 i Kodit Penal dhe atë të moskallëzimit të krimit të parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal.

1.16 Në shkelje të nenit 152/1,2 të Kodit të Procedurës Penale, në të cilin parashikohet se: *“1. Çmuarja e provave është përcaktimi i vërtetësisë dhe fuqisë provuese të tyre. Çdo provë i nënshtrohet shqyrtimit dhe nuk ka vlerë të paracaktuar. Gjykata i çmon provat sipas bindjes së formuar pas shqyrtimit të tyre në tërësi. 2. Ekzistenca e një fakti nuk mund të nxirret nga indicet përveçse kur këto janë të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën”*; dhe nenit 375 të Kodit të Procedurës Penale, në të cilin parashikohet se: *“Me vendimin përfundimtar gjykata mund t'i japë faktit një përcaktim të ndryshëm nga ai që ka bërë prokurori ose i dëmtuari akuzues, më të lehtë ose më të rëndë, me kusht që vepra penale të jetë në kompetencën e saj”*. Kjo pasi duke ndryshuar cilësimin juridik të veprës, gjykata ka lehtësuar pozitën e të pandehurit dhe për më tepër pas përsëritjes së pjesshme të hetimit

gjqësor, nuk rezulton që nga analiza e vlerësimit të fakteve dhe dëshmive të dëshmitarëve të pyetur, të kenë diktuar gjykatën për të ndryshuar cilësimin juridik të veprës.

1.17 Gjykata e Apelit Shkodër ka vijuar në aplikim të nenit 427 të Kodit të Procedurës Penale, duke përsëritur pjesërisht hetimin gjyqësor dhe në përfundim të gjykimit i ka dhënë faktit një përcaktim juridik të ndryshëm nga ai i prokurorit dhe vendimit të shkallës së parë lidhur me njërin prej të akuzuarve. Për të gjykuarin S. M ka bërë ndryshim të kualifikimit ligjor nga vepra penale “Vrasje në rrethana të tjera cilësuese” e kryer ndaj të miturit në bashkëpunim parashikuar nga neni 79/a-25 i Kodit Penal, në veprat penale të “Sigurimit të kushteve për të kryer vrasje” e “Moskallëzim krimi” parashikuar nga nenet 80 e 300 të Kodit Penal, duke lehtësuar në këtë mënyrë pozitën e të pandehurit.

1.18 Ligjërisht ky veprim është në kompetencën e kësaj gjykate dhe harmonizohet me përmbajtjen e nenit 375 të Kodit të Procedurës Penale. Por në analizë dhe në përputhje me faktet dhe provat e shqyrtuara në seancë gjyqësore nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër e të argumentuara në vendimin e saj, ky ndryshim i cilësimit juridik të veprës prej Gjykatës së Apelit Shkodër nuk është bindës dhe argumentues, pasi pas përsëritjes së pjesshme të hetimit gjyqësor nga kjo gjykatë, nuk rezulton që nga analiza e vlerësimit të fakteve dhe dëshmive të dëshmitarëve të pyetur, të mund të diktonin gjykatën për të ndryshuar cilësimin juridik të veprës në kundërshtim me parashikimet e nenit 152/1,2 të Kodit të Procedurës Penale.

1.19 Gjykata në ushtrimin e funksionit të saj juridiksional, duhet të sqarojë kuptimin e ligjit që duhet të zbatohet me qëllim që të eliminojë çdo dyshim që lidhet me cilësimin juridik të veprës, për të siguruar kështu stabilitetin e së drejtës dhe rivendosjen e rendit juridik të shkelur.

1.20 Lidhur me vendimin e gjykatës për cilësimin e ri të veprës penale të “Sigurimit të kushteve për të kryer vrasje”, vlerësojmë se, për të ekzistuar kjo akuzë duhet të plotësohen në mënyrë kumulative të dy elementët e saj: sigurimi i kushteve dhe për të kryer vrasje. Gjatë shqyrtimit, Gjykata e Apelit shprehet se i gjykuari S. M i ka siguruar kushtet, por nuk është vërtetuar se ai kishte dijeni se ndaj viktimës do të kryhej vrasja. Pra ky ndryshim dhe cilësim i ri nuk qëndron, pasi nuk plotësohet njëri prej elementeve të kërkuar në dispozitë, dijenia për të kryer vrasjen.

1.21 **Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit dhe deklaratimet e bëra në seancë dëgjimore, arrin në përfundimin se,** subjekti i rivlerësimit në çështjen me nr. vendimi ***, nuk ka respektuar vendimin e KLD-së, nr. ***, datë 14.04.2010, pasi gjykimi i kësaj çështjeje ka zgjatur për një periudhë kohore prej 10 muaj e 21 ditë nga momenti i kalimit të çështjes me short, pra jashtë afatit 9 muaj të përcaktuar në vendimin e KLD-së, pra subjekti nuk ka qenë i aftë të përballojë ngarkesën e punës, në aspektin e aftësive organizative të një gjyqtari.

1.22 Subjekti i rivlerësimit në çështjen me nr. vendimi ***, nuk ka respektuar nenin 379 të Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit marrja e vendimit nuk mund të shtyhet, përveçse në rast pamundësie absolute dhe shtyrja vendoset nga kryetari me urdhër të motivuar, pasi trupi gjykues ka shtyrë seancën e parafundit gjyqësore, pa qenë në kushtet e pamundësisë absolute për të dhënë vendimin, e për më tepër pa urdhër të motivuar të kryetarit të seancës për shtyrjen e seancës për shpalljen e vendimit të arsyetuar. Të gjitha seancat gjyqësore kanë filluar me vonesë, pa u pasqyruar në procesverbal shkaku i fillimit të tyre me vonesë duke shkelur Kodin e Etikës Gjyqësore, miratuar nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare, më datë 08.12.2006, rregullin 8 të saj, nenin 4 të Vendimit të KLD-së, nr. ***, datë 24.12.2008. Kjo praktikë e gabuar duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka aftësi për të kryer procedura gjyqësore dhe ka sjellë për pasojë uljen e transparencës së zhvillimit të gjykimeve në këtë gjykatë.

1.23 Subjekti i rivlerësimit, z. Luan Dervishi, në çështjen me nr. vendimi ***, nuk ka respektuar parashikimet e nenit 152/1,2 të Kodit të Procedurës Penale dhe 375 të Kodit të Procedurës Penale. Kjo pasi duke ndryshuar cilësimin juridik të veprës, gjykata ka lehtësuar

pozitën e të pandehurit dhe për më tepër pas përsëritjes së pjesshme të hetimit gjyqësor, nuk rezulton që nga analiza e vlerësimit të fakteve dhe dëshmive të dëshmitarëve të pyetur, të kenë diktuar gjykatën për të ndryshuar cilësimin juridik të veprës.

1.24 **Si konkluzion**, Komisioni, çmon se përfundimet e nxjerra nga dokumentacioni që disponon nga Ministria e Drejtësisë dhe faktet e bëra publike në media dhe shqyrtimi i këtij rasti në tërësinë e tij, nuk mund të konsiderohen si shkaqe për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, sipas parashikimeve të nenit 61, pika 4, e ligjit nr. 84/2016, por duhet të konsiderohen në vlerësimin tërësor të çështjes së subjektit të rivlerësimit.

1.25 Lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit se vendimet gjyqësore kontrollohen vetëm nga gjykata me e lartë, e se asnjë organ tjetër nuk mund të vlerësojë ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e vendimeve gjyqësore, për sa kohë, ato nuk janë ndryshuar ose prishur nga një gjykatë më e lartë, sipas parashikimeve të Vendimit nr. 11, datë 27.05.2004, të Gjykatës Kushtetuese

✓ *Komisioni arrin në konkluzionin se disa nga problemet e konstatuara nga hetimi dhe inspektimi kishin lidhje me burimet e vlerësimit të magistratëve sipas ligjit për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në republikën e Shqipërisë dhe jo me mënyrën se si subjekti i rivlerësimit e ka interpretuar ligjin. Në këto kushte, pretendimi i subjektit të rivlerësimit nuk qëndron.*

VIII. VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES

Në vlerësimin tërësor të çështjes, mbështetur në provat, faktet dhe rrethanat që Komisioni disponon për kriterin e vlerësimit e pasurisë, kontrollin e figurës, vlerësimin profesional si dhe vlerësimin tërësor të procedurave, Komisioni arrin në përfundimin se:

Për Vlerësimin e Pasurisë, Komisioni arrin në konkluzionin se:

1. Për sip trualli, me sipërfaqe 365 m², në bashkëpronësi me të tjerë me pjesë takuese 48 m², pranë shkollës “**”, Zona Kadastrale ***, regjistruar nr. ***, datë 25.09.1998, ***, Tiranë, subjekti i rivlerësimit:**

i. Nuk arriti të provojë se personat e tjerë të lidhur/dhuruesit e këtij trualli kishin burime të ligjshme për dhurimin e bërë.

2. Apartament banimi, me sip. 125 m² si dhe një garazh me sip.40 m², ndodhur në, Rr. “**”, Tiranë, me vlerë ndërtimi 2.500.000 lekë:**

i. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarin të rremë në lidhje me burimin e krijimit dhe kohën e pagimit të kësteve të ndërtimit të këtij apartamenti.

ii. Subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar të ardhurat që kanë shërbyer për ndërtimin e këtij apartamenti dhe garazhi.

iii. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarin të rremë në lidhje me shumë e përfituar nga qiraja e apartamentit dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar të ardhurat nga qiraja e apartamentit;

iv. Në lidhje me shitjen e këtij apartamenti, subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur në mënyrë të saktë pasurinë në posedim të tij dhe ka kryer deklarin të rremë;

3. Në lidhje të ardhurat nga qiraja e garazheve për vitet 2004, 2005 dhe 2006.

- i. Subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar të ardhurat nga qiraja e garazheve.

4. Në lidhje me garazhin me sip. 20 m².

- i. Subjekti i rivlerësimit ka fshehur numrin dhe sipërfaqen e saktë të garazheve në posedim. Ai nuk arriti të provojë bindshëm të kundërtën e rezultateve të hetimit.
- ii. Subjekti i rivlerësimit ka fshehur dhe paraqitur në mënyre të pasaktë pasuritë në posedim, me qëllim që të fshihte burimin e krijimit të tyre.

5. Për depozitën pranë “Credins Bank” në shumën 1.452.532,06 lekë.

- i. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të rrem në lidhje me burimin e krijimit të kësaj depozite në deklaratën “Vetting” të vitit 2017.

6. Lidhur me automjetin, tip “Ford Focus”.

- i. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të rrem në lidhje me mënyrën e shlyerjes dhe burimin që ka shërbyer për blerjen e këtij automjeti.
- ii. Subjekti i rivlerësimit ka fshehur huan e marr nga z. B. Ç, hua e cila ka shërbyer për blerjen e këtij automjeti në deklaratën “Vetting”.
- iii. Subjekti ka paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi dhe ka kryer deklaram të rrem.
- iv. Subjekti i rivlerësimit ka mungesë financiare nga burime të ligjshme në shumën - 1.998.185 lekë, në vitin 2011, që ka blerë këtë automjet

7. Për aksionet, “Bono Privatizimi”.

- i. Subjekti i rivlerësimit është në situatën e konfliktit të interesit.

8. Lidhur me vlerën prej 1.100.000 lekësh likuiditet në *cash* gjendje.

- i. Subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm burimin e krijimit të këtyre të ardhurave.
- ii. Subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare nga burime të ligjshme për të justifikuar të ardhurat e dërguara nga djali i subjektit, në shumën prej 10.000 USD.

9. Lidhur me banesën me sipërfaqe 60 m², në të cilën subjekti banon aktualisht, ndodhur në Tiranë.

- i. Subjekti i rivlerësimit është përpjekur të fshehtë këtë pasuri duke e regjistruar në emër të personit tjetër të lidhur/znj. M. Sh.

10. Për të ardhurat e personit të lidhur/djalit të subjektit.

- i. Subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm burimin dhe ligjshmërinë e të ardhurave të personit të lidhur/djalit të subjektit, për pagimin e kredisë së blerjes së makinës në shumë prej 64.000 USD, sipas kësteve të pagesës.
- ii. Personi i lidhur/djali i subjektit të rivlerësimit nuk arriti të provojë me dokumentacion ligjor justifikues ligjshmërinë e të ardhurave që kanë shërbyer për të shlyer këstet e

kredisë financiare të automjetit, tip “Toyota Camy”, si dhe shumën prej 15.000 USD për pagesën e shkollës së personit të lidhur/vajzës së subjektit.

11. Për të ardhurat dhe shpenzimet e personit të lidhur/vajzës së subjektit të rivlerësimit – A. D.

- i. Subjekti i rivlerësimit ka fshehur bursën e përfitur për periudhën 2012, 2013 në vlerën 22.500 USD.
- ii. Subjekti i rivlerësimit ka deklarim të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin në lidhje me burimin e financimit të studimeve të vajzës.
- iii. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në mënyrë të rremë shpenzimet e kryera për shkollimin e vajzës.
- iv. Subjekti i rivlerësimit ka fshehur shumën reale të shkollimit të vajzës, ku sipas dokumentacionit rezultoi shuma prej 8.721.836,651 lekësh, ndërkohë që subjekti ka deklaruar vetëm shumën prej 5.128.950 lekësh.

12. Lidhur me të ardhurat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën “Vetting” të vitit 2017.

- i. Subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion ligjor të ardhurat në shumën prej 5.175.400 lekësh (*si diferencë e të ardhurave të deklaruara në shumën 36.848.148 lekë me shumë e të ardhurave me dokumentacion justifikues ligjor shumën prej 31.672.748 lekësh*)

13. Për analizimin financiar të deklarimeve ndër vite të subjekti të rivlerësimit.

- i. Subjekti i rivlerësimit ka deklarime të pasakta, ka fshehur dhe ka kryer deklarim të rremë ndër vite pranë ILDKPKI-së.

Rezultatet e rivlerësimit të pasurisë:

Në përfundim të procesit të rivlerësimit të pasurisë, referuar nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, për subjektin e rivlerësimit, z. Luan Dervishi, rezultoi se :

- ❖ Ka pasur deklarime të pasakta dhe që vijnë në kundërshtim me germa “a”, pika 5, nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.
- ❖ Nuk ka pasur burime të ligjshme për justifikimin e pasurive, bazuar te germa “b”, pika 5, neni 33, të ligjit nr. 84/2016.
- ❖ Ka kryer fshehje pasurie, bazuar te germa “c”, pika 5, neni 33, të ligjit nr. 84/2016.
- ❖ Ka pasur deklarim të rremë, bazuar te germa “c”, pika 5, neni 33, të ligjit nr. 84/2016.
- ❖ Ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit, bazuar te germa “a”, pika 5, neni 33, të ligjit nr. 84/2016.

a. Në lidhje me Kontrollin e Figurës, Komisioni arrin në konkluzionin se:

Subjekti ka një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës

b. Për Vlerësimin Profesional, Komisioni arrin në përfundimin se:

- 14.** Subjekti i rivlerësimit ka demonstruar mungesë të aftësive organizative të një gjyqtari.

15. Përfundimet e nxjerra nga dokumentacioni që disponon nga Ministria e Drejtësisë dhe faktet e bëra publike në media dhe shqyrtimi i pavarur i këtij rasti në tërësinë e tij, janë të pamjaftueshme për t'u konsideruar si shkaqe për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit sipas parashikimeve të nenit 61, pika 4, e ligjit nr. 84/2016, por ato merren në konsideratë në vlerësimin tërësor të çështjes së subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 61, pika 5, e ligjit nr. 84/2016.

Në këto kushte, Komisioni, bazuar në provat që disponon, vlerësimin e çështjes në tërësi si dhe bindjen e brendshme vendosi që subjektit të rivlerësimit, z. Luan Dervishi, gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, t'i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë të ndryshuar si dhe nenit 61, pika 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë",

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Luan Dervishi, gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Shkodër.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisionerit Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, më datë 26.11.2018.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Firdes SHULI
Kryesues

Pamela QIRKO
Anëtare

Etleda ÇIFTJA
Relatore

Anisa DUKA
Sekretare gjyqësore